



# USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 29 (827781)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 22 Korrik 2022

## Qendra e Simulimit, inovacion, planifikim, projektim, përgatitje për komandantët, shtabet dhe liderët e së ardhmes

Qendra e Simulimit, si një risi e FA-ve, mjaft e rëndësishme për kontributin e saj operacional e projektuar, kompletuar dhe pajisur për të siguruar një mjedis trajnues me standardet e duhura të një ushtrie që aderon në forcën më të madhe transatlantike, vjen për publikun e gjerë nëpërmjet drejtorit të IKSHU Ulsi Rexhaj, i cili sjell në vëmendje aktivitetin dhe rëndësinë e kësaj qendre. Kur ka filluar funksionimin e saj Qendra e Simulimit dhe cilat

kanë qenë stërvitjet e para të realizuar në Qendër? Qendra e Simulimit (QS) ka nisur funksionimin në datën 24 tetor 2012, me mbështetjen e Zyrës Amerikane të Bashkëpunimit për Mbrojtjen. Iniciativa për krijimin e një kapaciteti mbështetës për stërvitjet në FARSH, nëpërmjet sistemeve të simulimit, ka nisur realisht që në vitin 2007 e përpjekjet kanë vijuar ndër vite për prokurimin e pajisjeve, strukturimin e plotësimin me personel dhe arritjen

e funksionimit normal të saj. Në vitet 2012-2017 në QS ka qenë i pranishëm një ekip i kontraktuar i kompanisë amerikane CUBIC, i cili ka ofruar asistencë teknike për personelin e qendrës sipas konceptit "over the shoulder". Stërvitjet e para të realizuara nga qendra kanë pasur karakter eksperimentues dhe konsolidues për procedurat dhe teknikat në përdorim dhe janë realizuar me kurset...

» faqe 6-7



## Shqipëria çeli negociatat për anëtarësim me BE-në Rama: Falënderoj popullin shqiptar për mosdorëzimin në ndjekjen e rrugës europiane



» faqe 3

Ministri Peleshi: Krenar për çka është arritur me mund, ku nga një vend konsumues i sigurisë, tashmë kontribuues i paqes dhe parimeve

Në këtë ditë të rëndësishme për popullin shqiptar, i cili prej disa dekadash thërret: "Duam Shqipërinë si gjithë Europa", me përpjekjet e jashtëzakonshme të qeverisë Rama për të bërë realitet këtë ëndërr shqiptare, familja e madhe europiane hapi dyert edhe për këtë vend të vogël, por me rëndësi të madhe gjeostrategjike. Ministri i mbrojtjes, z. Niko Peleshi, përshëndet popullin shqiptar për këtë arritje historike. "Sot jemi në një moment historik..."



» faqe 2

Deklaratë e zëvendësministres së Mbrojtjes, Dallëndyshe Bici

Sipas të dhënave më të fundit nga Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile, janë vënë nën kontroll 20 vatra zjarri, ku 10 prej tyre kanë qenë më problematike. Janë shuar dy vatrat në qarkun e Vlorës, ajo në fshatin Qesarat dhe në kodrat me ullinj të Pusit të Mezinut në qarkun e Vlorës. Në qarkun e Durrësit është neutralizuar vatra në "Makaresh", zonën e Krastës, në fshatin Bizë për të cilën është luftuar prej dy ditësh, në varrezat e vjetra të Durrësit si dhe në Gjirin e Lalzit, duke shmangur rreziqet për zonat e banuara.



» faqe 6

Gjeneral brigade Arben Kingji, vizitë zyrtare në Fort Drum, NY, SHBA

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, zhvilloi një vizitë zyrtare në Fort Drum, NY, SHBA. Gjatë kësaj vizite, së bashku me Adjutant Komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou, vizituan ushtarakët e Brigadës së 44-të të Këmbësorisë, në kuadër të stërvitjes "eXportable Combat Training Capability", ku pjesë e këtij trajnimi janë edhe 47 efektivë nga Grup Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë.



» faqe 5

## Ministri Peleshi:

# Krenar për çka është arritur me mund, ku nga një vend konsumues i sigurisë, tashmë kontribuues i paqes dhe parimeve demokratike në rajon dhe botë

Në këtë ditë të rëndësishme për popullin shqiptar, i cili prej disa dekadash thërret: “Duam Shqipërinë si gjithë Europa”, me përpjekjet e jashtëzakonshme të qeverisë Rama për të bërë realitet këtë ëndërr shqiptare, familja e madhe europiane hapi dyert edhe për këtë vend të vogël, por me rëndësi të madhe gjeostrategjike.

Ministri i mbrojtjes, z. Niko Peleshi, përshëndet popullin shqiptar për këtë arritje historike.

“Sot jemi në një moment historik të udhëtimit tonë drejt anëtarësimit të plotë mes vendeve të Bashkimit Europian. Është vetëm një stacion, por tejet i rëndësishëm.

Mbetemi të angazhuar për të përmbyshur të gjitha objektivat për të mos ndalur ecurinë pozitive të reformave dhe të rrugëtimit tonë drejt familjes së madhe europiane. Në momentet më kyçe të historisë sonë, kemi treguar se Shqipëria nuk është në Europë vetëm gjeografikisht, por edhe kulturisht, duke pasqyruar vlerat më të mira të civilizimit perëndimor. Krenar për atë çka është arritur me shumë mund deri tani, ku nga një vend konsumues i sigurisë, tashmë është kontribuues i paqes dhe i përhapjes së parimeve demokratike kudo në rajon dhe botë”.



## Deklaratë e zëvendësministres së Mbrojtjes, Dallëndyshe Bici

Sipas të dhënave më të fundit nga Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile, janë vënë nën kontroll 20 vatra zjarri, ku 10 prej tyre kanë qenë më problematike.

Janë shuar dy vatrat në qarkun e Vlorës, ajo në fshatin Qesarat dhe në kodrat me ullinj të Pusit të Mezinit në qarkun e Vlorës.

Në qarkun e Durrësit është neutralizuar vatra në “Makaresh”, zonën e Krastës, në fshatin Bizë për të cilën është luftuar prej dy ditësh, në varrezat e vjetra të Durrësit si dhe në Gjirin e Lalzit, duke shmangur rreziqet për zonat e banuara.

Më e qetë është situata edhe në një vatër në fshatin Patin në Klos. Është shuar një vatër e raportuar në Vorë në fshatin Marikaj dhe fshatin Dushk në bashkinë Lushnje.

Puna vijon në shpatin e malit në Balldren, ku situata është normalizuar, në fshatin Shetaj në Durrës, në fshatin Lgjin në Orosh të Mirditës, ku është aktivizuar sërish një vatër si dhe në fshatin Lekbibaj në Tropojë.

Gjatë dy muajve të sezonit të verës, qershor - korrik për shkak edhe të temperaturave të larta që kanë përfshirë të gjithë rajonin e Europës, në të gjithë vendin janë shfaqur 220 vatra zjarri në 42 bashki të vendit.

Prefekturat të cilat kanë pasur numrin më të lartë të vatrave të zjarreve kanë qenë



Fieri, Shkodra, Vlora dhe Tirana.

Në menaxhimin e situatave të zjarreve, gjatë kësaj periudhe janë angazhuar në total 3.088 forca dhe 320 mjete nga: Forcat e Armatosura, Forcat Zjarrfikëse, Policia e Shtetit, forca vullnetare, trupa të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Shërbimit Pyjor si dhe punonjës të pushtetit vendor.

Në dy operacione për shuarjen e zjarreve, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile i është drejtuar Mekanizimit Europian të Mbrojtjes Civile për ndihmë.

Të gjitha strukturat e sistemit të Mbrojtjes Civile janë në gatishmëri të plotë me të gjitha kapacitetet nga toka dhe ajri.

U bëjmë thirrje qytetarëve të cilësojnë veten pjesë të Mbrojtjes Civile, të bëjnë kujdes dhe të raportojnë në kohë zjarret, në mënyrë që të parandalohet përhapja e tyre në sipërfaqe më të mëdha. Bashkëpunoni me pushtetin vendor, njoftoni sa më shpejt të mundeni zjarrfikësit! Zjarret e qëllimshme, ose nga pakujdesia dënohen sipas ligjit.

### Forcat e Armatosura, angazhim maksimal në situatën e krijuar nga zjarret në malin e Çikës

Stina e nxehtë e verës, por edhe papërgjegjshmëria e individëve të caktuar, duket se kanë qenë shkaktarët e disa zjarreve të shpërthyer në vendin tonë, ditët e fundit. Situata më e fundit, ishte ajo e shpërthimit të zjarrit në malin e Çikës, Vlorë. Ashtu si edhe herët e tjera, kjo situatë e rënduar gjeti reagimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura. Ditën e djeshme, me marrjen e urdhrat për ndërhyrje, Forcat e Armatosura angazhuan një personel prej mbi 100 vetash dhe 12 mjete, të mbështetura edhe nga një dron. Personeli i angazhuar ishte pjesë e strukturave të Forcës Tokësore, Komandës së Mbështetjes si dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Operacioni u zhvillua në kushte të një terreni malor ku masivi i shkurreve dhe pyjeve, që ishin duke djegur në këtë zonë, gërshtohej gjithashtu edhe nga terreni tepër shkëmbor, çka e vështirësonte së tepërmi fikjen e flakëve të zjarrit. Si rrjedhojë, trupat u detyruan që të ecin për disa orë në këmbë, për të arritur në zonën e operacionit.

Me gjithë përpjekjet për fikjen e zjarrit nga toka, duke qenë se terreni ishte tepër i vështirë për ndërhyrje të mëtejshme, fikja përfundimtare e zjarrit u krye nga dy avionë të posaçëm për emergjencë të këtij lloji, të ardhur nga Republika e Greqisë. Forcat e Armatosura bëjnë thirrje për më tepër përgjegjshmëri nga të gjithë qytetarët e republikës, për të shmangur në të ardhmen situata të tilla, të cilat na dëmtojnë të gjithëve.



## Shqipëria çeli negociatat për anëtarësim me BE-në

## Rama: Falënderoj popullin shqiptar për mosdorëzimin në ndjekjen e rrugës europiane

**16** vite pas firmosjes së marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, Shqipëria, në ditën historike të 19.7.2022, çel negociatat për anëtarësim me Bashkimin Europian. Në konferencën e parë ndërqeveritare, mbajtur në Bruksel, kreu i qeverisë Edi Rama e konsideroi anëtarësimin në BE, një çështje për “jetë a vdekje”, ndërsa u shpreh se vendi do të vijojë në përmbushjen e sfidave.

“Ia dolëm të dëshmojmë se ishim më të mirë e më të fortë. Nuk ka të bëjë vetëm për ne, bëhet fjalë për të ardhmen europiane. BE ka qenë më shumë se sa raporte apo shkresa. Edhe pse u shtynë padrejtësisht për tre vite, ne vijuan edhe me më shumë këmbëngulje.

Sot Shqipëria është vendi më i avancuar në rajon. Shkatërruam pallatin e vjetër të drejtësisë së korruptuar. SPAK dhe BKH janë thelbësor në këtë epokë të re. Nëse pak vite më parë, mund të kishit pyetur dikë për një politikan pas hekurave, do kishin qeshur me ju. Sot askush nuk ka imunitet. Barazia përballë drejtësisë është e mundshme dhe e arritshme.

Qëndroj këtu si lider i një maxhorance, të zgjedhur në mënyrë demokratike, që nuk ka mbrojtur askënd nga drejtësia. Sigurisht shumë hije të së shkuarës vijojnë, kjo është arsyeja pse jemi këtu.

I bashkohemi SHBA-ve si penëmbajtëse për luftën në Ukrainë, do vijojmë të luajmë rol kyç në konfigurimin e ri gjeopolitik. Ndjekim një rrugë konsistente me BE-në nga viti 2014, mbi politikën e jashtme. Iniciuam nismën Ballkanike të quajtur “Open Balkan”.

Dua të kujtoj se nuk do jenë vetëm 2 por 4 nga 6 shtete të Ballkanit. Në një zonë si Ballkani, do të thotë më pak fantazma nga historia në jetën tonë politike. Duke qenë 4 vende për t’u bashkuar me BE-në, përgjysmohet fryma e ndarjes. Pavarësisht zhgënjimeve, BE nuk është një projekt që do të përfundojë një ditë. Ndiham pas tërmetit, gjatë pandemisë, investimet, kanë luajtur një rol për vendin tonë. Pozicioni ynë ekonomik të jetë në



përpjesëtim me shtetet anëtare të BE.

Do angazhohemi në planet e vepërimit të transportit dhe për të zgjeruar korsitë e gjelbra. Do investojmë në ndërlikimin kombëtar dhe rajonale.

Nga ana tjetër duam të bëhemi kampion rajonalë të epokës dixhitale. Tek flasim po luftojmë ndaj një sulmi kibernetik, nga një vend armiqësor me BE-në, por sistemi ynë po reziston. Ne jo vetëm do

vijojmë të raportojmë periodikisht, por do gjejmë mënyra për të rritur cilësinë.

Në të njëjtën kohë do punojmë për sfidat dhe mundësitë për anëtarësimin në BE. Ndërsa ne festojmë me entuzi-



azëm sot, nuk kemi qenë kurrë më të vetëdijshëm për sfidat. Shumë europianë duhet ta kuptojnë se BE ka nevojë për Ballkanin po aq sa Ballkani ka për BE-në. Shumë që nuk kuptojnë çfarë e motivoi projektin duhet ta shohin tani. Ka nevojë për një Europë të rinovuar. Po, është një luftë e vazhdueshme: Vetë lufta drejt lartësive mjafton për të mbushur zemrën e njeriut.” - u shpreh Rama.

Ndërsa në fjalën e tij falënderuese

Rama, shprehu mirënjohjen për ekipin e Presidentit Macron, dhe kontributin e dhënë në zhblokimin e ngërçit mes Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë.

“Dua të falënderoj një tjetër zonjë gjermane që nuk është më aktive, por pa të cilën nuk do të ishim këtu dhe kjo është ish-kancelarja Angela Merkel. Ajo ka ditëlindjen dhe do të doja t’i uroja gjithë të mirat.

Rama falënderoi dhe popullin shqiptar, për mosdorëzimin në ndjekjen e rrugës europiane

Nga ana e saj Presidentja e Komisionit Europian, Von der Leyen, e cilësoi një moment historik çeljen e negociatave për Shqipërinë. Ajo vlerësoi gjithashtu kryeministrin Edi Rama për punën e shkëlqyer gjatë 3 mandateve qeverisje.

“Ky është një moment historik, sot Shqipëria ka hapur negociatat për aderimin në BE dhe jam shumë e lumtur që jam këtu me ju. Ky është sukcesi juaj, i juaji si qeveri dhe i qytetarëve tuaj. Keni punuar kaq shumë për të arritur deri këtu. Ju keni bërë ndryshim, jo vetëm aty ku janë të detyrueshme për rrugën drejt BE-së, pro sepse janë të mira

për vendin tuaj.

Këto reforma po japin një cilësi më të mirë jetese. Ne si KE ju kemi mbështetur dhe do të vazhdojmë ta bëjmë.

I dashur Edi, ju keni treguar kaq shumë leadership, vizion, durim strategjik me sasi të mëdha. Populli shqiptar e meriton dhe ne të gjithë do të jemi bashkë kur do të presim Shqipërinë si të barabartë në BE”, - tha presidentja e BE-së.



Ekipi i FSK-së zhvilloi vizita dhe takime të veçanta në komandën e Forcës Ajrore, Bazën Ajrore Farkë, si dhe në Agjencinë Kombëtare Të Menaxhimit Të Fluturimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, "Albcontrol sh.a." në Rinas.

## Gjeneral brigade Pulaj: Forca Ajrore shqiptare do të ofrojë gjithë kapacitetet e saj për zhvillimin e FSK-së edhe në domenin ajror

**N**ë kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, një ekip i FSK, kryesisht pilotë, zhvilluan një vizitë disaditore në njësitë dhe repartet e Forcës Ajrore si edhe në strukturat e "Albcontrol sh.a."

Ky ekip i FSK-së u prit në takim të veçantë edhe nga komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Pulaj, i cili në fjalën e tij theksoi se ndërmjet Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe pilotëve të FSK-së, do të ketë bashkëpunimin të vazhdueshëm, jo vetëm për të parë nga afër procesin e punës të koordinimeve të fluturimeve mes kullës ajrore civile dhe asaj ushtarake, mënyrën e organizimit të strukturave të Komandim Kontrollit Ajror dhe procedurat e koordinimit me strukturat homologe civile, por se Forca Ajrore shqiptare do të ofrojë të gjithë ekspertizën dhe kapacitetet e saj për zhvillimin e FSK edhe në domenin ajror.



Ekipi i FSK-së zhvilloi vizita dhe takime të veçanta në komandën e Forcës Ajrore, Bazën Ajrore Farkë, si dhe në Agjencinë Kombëtare Të Menaxhimit Të Fluturimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, "Albcontrol sh.a." në Rinas.

Ky aktivitet u pasqyrua dhe në NATO, mediat e KFOR-

it si dhe ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj, shprehu në postimin e tij se: "Forcat Ajrore të Republikës së Shqipërisë mbështesin Repartin

Ajror të FSK-së. Ne vazhdojmë së bashku të rrisim kapacitetet tona të përbashkëta në aftësitë e mbrojtjes ajrore. Së bashku jemi gjithmonë më të fortë".

**A**nija P-134 "Butrinti" zhvilloi një vizitë portuale në Toulon, Francë dhe Civitavecchia, Romë, Itali.

Komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i Rangut I Engjëll Sinanaj, përshëndeti dhe iu uroi efektivitet të anijes P-134 "Butrinti" udhëtim të mbarë.

Kjo vizitë është një eveniment që realizohet për herë të parë dhe përbën një ngjarje historike, në të cilën anija e Forcës Detare merr pjesë në këtë vizitë gjatë së cilës ka kaluar në ngushticën e Mesinës dhe ngushticën e Bonifacios.

Komandanti i anijes P-134 "Butrinti", kapiten i Rangut III Altin Licaj, realizoi një vizitë në Komandën e Bazës Detare së Toulonit, Francë, ku u prit nga komandanti i Bazës, kapiten Christophe Bourmaud dhe shefi operacional francez i Mesdheut, kapiten Pascal Forissier. Gjatë takimit u diskutua në lidhje me shkëmbimin e eksperiencave, bashkëpunimin në stërvitje dhe vizitave portuale të mëtejshme midis dy vendeve.

Komandanti i Anijes P-134 "Butrinti", u prit gjithashtu dhe nga përfaqësuesi bashkiak i Toulonit, M. Guy Le Berre, i cili shprehu mirëseardhjen në vizitën e tyre të parë zyrtare të anijes së Forcës Detare të Shqipërisë.

Gjatë vizitës në Civitavecchia,

## Anija P-134 "Butrinti", vizitë portuale në Toulon, Francë dhe Civitavecchia, Itali



Itali, komandanti i anijes P-134 "Butrinti", u prit nga komandanti i Rojës Bregdetare italiane, admiral Filippo Marini, i cili shprehu

mirëseardhjen dhe dëshirën për rritjen e bashkëpunimit të ndërsjellë midis dy vendeve. Gjithashtu, efektiviteti i anijes P-134 "Butrinti" u vizitua

dhe nga ambasadorja e Republikës së Shqipërisë në Itali, znj. Anila Bitri e shoqëruar dhe nga atasheu ushtarak kolonel Edmond Voci.

**Specialistët EOD eliminojnë rrezikun e municioneve të paplasura në fshatrat Ziçisht dhe Koshnicë, Bashkia Korçë**

**P**as njoftimit të marrë për gjetjen e një municioni të paplasur, i cili rrezikonte jetën e banorëve të fshatit Ziçisht, pesë ekspertë EOD u gjendën menjëherë në vendndodhjen e raportuar, ku nën masa të larta sigurie dhe pas një pune të kujdesshme, u konstatua se municioni ishte një predhë artilerie 76 mm me djegore të vendosur. Nisur nga kjo gjendje, ky municion u cilësua si i paprekshëm dhe i palëvizshëm. Specialistët morën vendimin që kjo predhë ishte e rrezikshme të transportohej dhe u realizua asgjësimi i saj në vend.

Pas kësaj ekipe EOD e vazhdoi detyrën në fshatin Koshnicë ku, pas rikonicionit të municionit, rezultoi se ai ishte një granatë dore mësymëse me tapë e pa dezës. Ky municion u mor për t'u magazinuar në repart.



# Gjeneral brigade Arben Kingji, vizitë zyrtare në Fort Drum, NY, SHBA



Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, zhvilloi një vizitë zyrtare në Fort Drum, NY, SHBA. Gjatë kësaj vizite, së bashku me Adjutant Komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou, vizituan ushtarakët e Brigadës së 44-të të Këmbësorisë, në kuadër të stërvitjes "eXportable Combat Training Capability", ku pjesë e këtij trajnimi janë edhe 47 efektivë nga Grup Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë.



Batalioni i Parë i Këmbësorisë, pjesë e operacionit për fikjen e zjarrit dhe mbajtjen nën kontroll të tij, në zonën e Oroshit, Mirditë.



**Efektivët e Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë vijojnë trajnimin mbi shëndetësinë dhe mortajat në Fort Drum, SHBA**



Simulimi është një metodë që përdoret gjerësisht si në fushën ushtarake, ashtu edhe në fusha të ndryshme të industrisë dhe botën akademike, si një mjet që mundëson aktivitete trajnimi/stërvitjeje, edukimi dhe ato kërkimore e shkencore, me kosto të reduktuar dhe rreziqe operationale të papërfillshme.



Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,  
Shefe e Sektorit të Botimeve

INTERVISTË ME DREJTORIN E IKSHU ULSI REXHAJ

# Qendra e Simulimit, inovacion, planifikim, projektim, përgatitje për komandantët, shtabet dhe liderët e së ardhmes

**Q**endra e Simulimit, si një risi e FA-ve, mjaft e rëndësishme për kontributin e saj operacional e projektor, kompletuar dhe pajisur për të siguruar një mjedis trajnues me standardet e duhura të një ushtrie që aderon në forcën më të madhe transatlantike, vjen për publikun e gjerë nëpërmjet drejtorit të IKSHU Ulsi Rexhaj, i cili sjell në vëmendje aktivitetin dhe rëndësinë e kësaj qendre.

**Kur ka filluar funksionimin e saj Qendra e Simulimit dhe cilat kanë qenë stërvitjet e para të realizuar në Qendër?**

Qendra e Simulimit (QS) ka nisur funksionimin në datën 24 tetor 2012, me mbështetjen e Zyrës Amerikane të Bashkëpunimit për Mbrojtjen. Iniciativa për krijimin e një kapaciteti mbështetës për stërvitjet në FARSH, nëpërmjet sistemeve të simulimit, ka nisur realisht që në vitin 2007 e përpjekjet kanë vijuar ndër vite për prokurimin e pajisjeve, strukturimin e plotësimin me personel dhe arritjen e funksionimit normal të saj. Në vitet 2012-2017 në QS ka qenë i pranishëm një ekip i kontraktuar i kompanisë amerikane CUBIC, i cili ka ofruar asistencë teknike për personelin e qendrës sipas konceptit “over the shoulder”.

Stërvitjet e para të realizuara nga qendra kanë pasur karakter eksperimentues dhe konsolidues për procedurat dhe teknikat në përdorim dhe janë realizuar me kurset institucionale të institucioneve arsimore të FARSH, si cikli i stërvitjeve “Preza 2012-2013”, e realizuar me kursantët e KTHOSH në AFA, ndërsa stërvitjet e para të mirëfillta të mbështetura nga QS kanë qenë “Joint Reaction 13”, një stërvitje në nivel “Joint”, nën kornizën e iniciativës së Kartës së Adriatikut, me pjesëmarrjen e forcave të SHBA-ve dhe vendeve të A-5 me qëllim rritjen e bashkëpunimit, koordinimit dhe ndërveprimit në operatione ushtarake në përgjigje të krizave, si dhe stërvitja kombëtare “SFJZ 13 South”, “Manza 13”, “Shkumbini 13”, etj.

**Çfarë përfaqëson kjo qendër dhe cili është ndikimi i saj në procesin e stërvitjes dhe trajnimit në FARSH?**

Qendra është një institucion inovator për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e kapaciteteve



stërvitore kolektive në FARSH. Synimi kryesor i Qendrës, që nga themelimi i saj ka qenë të shërbejë si një katalizator për rritjen e kapaciteteve operationale dhe përgatitjes profesionale të efektivëve të FARSH-it, nëpërmjet përdorimit të burimeve efikase njerëzore dhe teknike në disponim, si dhe futjes dhe implementimit të metodave të reja e bashkëkohore stërvitore, në përputhje me standardet e NATO-s dhe vendeve të zhvilluara.

Në procesin e stërvitjes dhe trajnimit në FARSH, Qendra e Simulimit ruan një rol të rëndësishëm, i cili mund të vërehet edhe në numrin e stërvitjeve të mbështetura nga Qendra, por dhe përfshirjen e saj në aktivitetet kryesore stërvitore e të planëzimit stërvitor në nivel FARSH. Që nga viti 2012, QS ka mbështetur rreth 90 për qind të stërvitjeve kolektive, ndër të cilat

26 stërvitje kombëtare në nivel togë/kompani, 35 stërvitje në nivel batalioni, 4 stërvitje në nivel brigade, dhe 10 stërvitje me karakter ndërinstitutional. Gjithashtu QS ka mbështetur 12 stërvitje të përbashkëta të realizuara me partnerë ndërkombëtarë, dhe 5 stërvitje të realizuara në kuadër të NATO-s. Numri total i personelit vendas e të huaj të angazhuar në stërvitje të mbështetura nga QS ndër vite është rreth 8000 vetë.

Ndërkohë QS është pjesëmarrëse e pazëvendësueshme në të gjitha aktivitetet planëzuese stërvitore në nivel kombëtar, e gjithnjë e më shumë efektiv i QS angazhohet në struktura planëzuese të nivelit më të lartë edhe në stërvitje të përbashkëta në të cilat angazhohet FARSH. Këto rezultate janë krenaria e QS, dhe gjithashtu përbëjnë një motivim të shtuar për personelin e QS.

**Cili është misioni dhe detyrat kryesore të Qendrës?**

Misioni i Qendrës është “trajnimi dhe zhvillimi i stërvitjeve me simulim i personelit ushtarak të FARSH, ndërinstitutionale, kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me bazën kombëtare doktrinare e konceptuale dhe atë të NATO-s, si dhe testimi i procedurave të vendimmarrjes, të komandave dhe shtabeve nëpërmjet metodave aplikative bashkëkohore”, ndërsa detyrat kryesore të saj janë:

□ Drejtimi dhe menaxhimi i stërvitjeve me simulim.

• Aplikimi i metodave dhe teknologjisë së përparuar për trajnim e stërvitje, përfshirë programet JCATS, VBS dhe JEMM, si dhe gjenerimi dhe krijimi i një mjedisi efektiv dhe real dhe me një kosto të ulët.

• Hulumtimi mbi performancën në stërvitje dhe propozime për përmirësimin e gjendjes.

**Çfarë përfitimesh sjell përdorimi i simulimit në stërvitje dhe si i shërbejnë ato FARSH?**

Simulimi është një metodë që përdoret gjerësisht si në fushën ushtarake, ashtu edhe në fusha të ndryshme të industrisë dhe botën akademike, si një mjet që mundëson aktivitete trajnimi/stërvitjeje, edukimi dhe ato kërkimore e shkencore, me kosto të reduktuar dhe rreziqe operationale të papërfillshme. Në rastin tonë, programet simulative mundësojnë mbështetjen dhe realizimin e stërvitjeve kolektive të forta dhe në kushte sa më reale, duke arritur përbushjen e objektivave stërvitore të shtabeve e planëzuesve në nivele të ndryshme, me një kosto pothuajse të papërfillshme në krahasim me kostot e zhvillimit të të njëjtave stërvitje në terren. Por, krahas kostos së reduktuar dhe realizimit të stërvitjeve dhe trajnimeve në një mjedis të kontrolluar, simulimi dhe përdorimi efektiv i programeve simulative për stërvitje e trajnim i ndihmon liderët e të gjitha niveleve të arrijnë ekspertizën taktike dhe teknike që nevojitet për operationet të suksesshme luftarake dhe jo luftarake, brenda vendit dhe në kuadrin e Aleancës, duke “provuar veten” në skenarë të ndryshëm.

**Si realizohen stërvitjet me simulim? Si realizohen stërvitjet e ndërthurura live/simex dhe si angazhohet QS në to?**

Stërvitjet me simulim ndjekin të njëjtat parime e metodologji planëzimi sikurse dhe stërvitjet tradicionale në terren. Publikimi i NATO-s “075-003” i vitit 2013, “Direktiva për stërvitjet dhe trajnimet kolektive”, e njohur nga ekspertët e fushës si “BISC 075-003”, jep një panoramë të plotë të të gjitha aktiviteteve planëzuese për çdo etapë stërvitore. Gjithashtu kjo direktivë, e cila është një dokument thelbësor në përdorim nga QS, parashtrohet dhe kërkesat e veçanta në



kuadër të ndërthurjes së simulimit dhe eksperimentimit në stërvitjet e trajnime kolektive. Përfitimet që sjell simulimi në aspektin teknik të menaxhimit të stërvitjeve e trajnimeve, lejojnë formësimin e skenarëve të ndryshëm dhe elementëve të ndryshëm kundërshtarë e jo vetëm pjesëmarrës në to, duke i ofruar njësisë e forcave nën trajnim kushte optimale për realizimin e objektivave stërvitore të vendosura. Por gjithashtu, duhet mbajtur parasysh se përdorimi optimal i programeve simulative kërkon ekspertizë dhe kapacitete teknike të caktuara, dhe sidomos se simulimi është plotësues i metodave tradicionale të stërvitjes/trajnitimit dhe jo zëvendësues.

Në konceptin aktual të stërvitjeve dhe trajnimeve kolektive, simulimi paraqet një mjet të fuqishëm për realizimin e objektivave të stërvitjeve e trajnimeve, dhe në praktikë gjithnjë e më shumë vendet e Aleancës e përdorin simulimin për stërvitjen e trajnimin e shtabeve dhe udhëheqësve ushtarakë të niveleve të ndryshme, krahas stërvitjes në kushte reale. Stërvitja në një mjedis të ndërthurur, simulativ dhe real, është sfida e stërvitjes dhe trajnitimit ushtarak të së ardhmes. Sipas karakteristikave të këtyre stërvitjeve dhe sidomos objektivëve stërvitorë të vendosur, një pjesë e njësisë në stërvitje kryejnë veprimtarinë në terren real, ndërsa një pjesë tjetër e veprimtarive stërvitore kryhet në mjedis të simuluar. Këtu duhet mbajtur parasysh se stërvitje të këtilla janë zakonisht të llojit komandë-shtabi, dhe sipas kërkesave specifike të stërvitjes, shtabet e niveleve të ndryshme mund të angazhohen në mjedise të veçanta. Këto lloj stërvitjesh paraqesin një sfidë të veçantë jo vetëm për planëzuesit e stërvitjeve në njësitë nën trajnim, por sidomos dhe stafin teknik mbështetës, sidomos ata të simulimit.

QS në vitet e fundit ka pasur mundësinë të angazhohet e të ofrojë mbështetje në dy stërvitje të përbashkëta madhore të realizuara në një

mjedis stërvitor të ndërthurur, stërvitjet “Joint Effort 16” dhe “Defender Europe 21”, si dhe disa stërvitje kombëtare.

#### **Cilat janë karakteristikat e sistemit stërvitor në QS?**

Sistemi stërvitor në QS është një kombinim i tre elementeve kryesorë e të pazëvendësueshme: personeli i specializuar, programet e simulimit në disponim dhe infrastruktura mbështetëse, ku përfshihen mjetet e pajisjet e teknologjisë së informacionit, si dhe infrastruktura didaktike e përshtatshme. Të gjithë këto elementë funksionojnë së bashku e njëkohësisht për të mbështetur stërvitjen në përputhje me doktrinat, teknikat dhe procedura të miratuara. Ndërveprimi e funksionimi sinergjik i të gjithë këtyre elementëve është i domosdoshëm për realizimin e misionit të qendrës, prandaj dhe një pjesë e veçantë e vëmendjes së QS i kushtohet aftësimi e trajnimin të vazhdueshëm të stafit dhe testimin e kolaudimit të infrastrukturës digjitale e fizike.

#### **Çfarë metodologjish dhe programesh simulative përdoren aktualisht në QS?**

Qendra e Simulimit ka në përdorim dy programe simulimi. Këto përfshijnë:

1. Programin për Simulimet Taktik dhe të Konfliktit të Përbashkët (JCATS)

2. Programin Hapësira Virtuale e Betejës 2 (VBS-2)

Të dy programet janë sisteme të mirënjohura dhe të përdorura gjerësisht nga vendet e NATO-s, dhe shumë vende të tjera.

Programi i simulimit JCATS është sistem simulimi i përbashkët, gjithëpërfshirës (forcë ajrore, tokësore, dhe detare) dhe ndërveprues me rezolucion të lartë dhe me përshtatshmëri në të gjithë spektrin e kërkesave operacionale. Ai mundëson modelimin e luftimeve në terren të dixhitalizuar, duke përdorur mbi 100 000 agregate dhe sisteme individuale.

JCATS është shumë efektiv kur përdoret për të trajnuar komandantë dhe shtabe nga nivel kompanie deri në nivel brigade, dhe përdoret në mënyrë intensive nga SHBA-ja dhe vendet të tjera të Aleancës për të përgatitur repartet/njësitë e saj. JCATS përdoret në zgjidhjen e detyrave për të gjitha llojet e operacioneve në të cilat mund të angazhohet FARSH.

Programi i simulimit VBS2 është një platformë ndërvepruese, e bazuar në ushtrime tredimensionale, e cila përfshin një mjedis virtual me besnikëri shumë të lartë ndaj realitetit, skenarëve e drejtuesve. VBS2 mbështet simulimin e mjeteve tokësore detare e ajrore, armët e kalibrin të vogël dhe armët në mjete, komunikimin, radarët, dylbitë termalë dhe forca kundërshtarë ndëraktive, duke përfshirë një shumëllojshmëri të mjeteve shpërthyes (IED). Për më tepër, siguron një mjedis gjithëpërfshirës në nivel personal dhe kryen trajnimin e personelit nga individë deri në nivel toge. Karakteret mund të jenë të kontrolluar nga kompjuteri ose nga inteligjencë artificiale.

Të dyja programet e simulimit janë të instaluar, operacionale dhe të përdorura vazhdimisht nga QS në stërvitjet e planëzuara të FARSH. Ndërkohë QS është gjithnjë e përditësuar me zhvillime të reja teknologjike dhe metodologji të ndryshme në përdorim kryesisht nga Aleanca. Si institucion me ekspertizë në këtë fushë ndjek zhvillimet në sektorin e simulimit për përdorim ushtarak, si dhe ofron propozime, duke u mbështetur në disa parime kryesore, të cilat janë:

- Raporti kosto-përfitim në investimin për përthithjen e sistemeve simulative - Sistemet stërvitore me simulim janë relativisht sisteme të kushtueshme për ushtri me kapacitete të kufizuara, dhe krahas koston së prokurimit të programeve të veçanta simulative, duhet përlllogaritur kostoja e gjithë elementëve të sistemeve stërvitore me simulim (personel dhe infrastrukturë, krahas programeve).

- Përputhja e kapaciteteve simulative me nivelin e ambicies kombëtare/nevojën për stërvitje/trajnim kolektive dhe individuale - Sistemet simulative duhet të përzgjidhen në përputhje me synimet e ambiciet kombëtare për kapacitetet ushtarake. Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh se simulimi është plotësues i metodave tradicionale të stërvitjes/trajnitimit dhe jo zëvendësues i tyre.

- Përzgjedhja e programeve simulative për përdorim të sintetizuar të tyre në stërvitje - Sistemet e simulimit për stërvitje/trajnim duhet të përzgjidhen në mënyrë të atillë që të garantojnë bashkëveprim midis tyre dhe një mjedis stërvitor sintetik.

- Ndërveprueshmëria e sistemeve simulative në nivel Combined&Joint (NATO) - Investimet në sisteme simulative duhet të synojnë arritjen e ndërveprueshmërisë së plotë me sistemet simulative në përdorim të aleatëve/partnerëve kryesorë. Gjithashtu investimet e përbashkëta mund të rezultojnë shpesh herë më të favorshme se investimet kombëtare individuale.

- Nevoja për stërvitje e testim/kolaudim të operacionalitetit të sistemeve C4ISR dhe sistemeve të armatimit në disponim nga FA - Sistemet simulative janë të lidhura kryesisht me nevojën për stërvitje/trajnim me sistemet C4ISR dhe ato të armatimit në disponim. Nëse nuk ka sisteme C4ISR apo armatimi komplekse nevoja për sisteme simulative komplekse reduktohet.

#### **A ka kjo qendër burime njerëzore dhe logjistike për mbështetjen me efikasitet të stërvitjeve, dhe cilat janë sfidat në këtë aspekt?**

Si pjesë e pazëvendësueshme e sistemit stërvitor në qendër, elementët e personelit dhe infrastrukturës, kanë një rëndësi thelbësore për mirëfunksionimin e QS. Me kapacitetet e saj, QS është e angazhuar për trajnimin e vazhdueshëm të personelit dhe mirëmbajtjen e infrastrukturën në përdorim. Trajnimi i personelit ka qenë një ndër

drejtimet kryesore të punës në QS dhe sidomos përcjellja e njohurive gjatë lëvizjeve të personelit. Investimet e vazhdueshme me qëllim kufizimin e ndikimit të amortizimit në pajisje e infrastrukturë mbesin një sfidë për QS.

Me qëllim forcimin e kapaciteteve ekzistuese dhe rritjen e kapaciteteve stërvitore QS është përfshirë së fundmi në një projekt investimi e modernizimi i cili pritet t'i japë një frymëmarrje të re Qendrës, por edhe të zgjerojë aftësitë trajnuese e stërvitore të saj.

#### **Çfarë siguron aktualisht Qendra e Simulimit? Cilat janë sfidat dhe cilat janë synimet e saj?**

QS ofron për gjithë njësitë e FARSH dhe institucioneve të mbrojtjes e sigurisë në vend një kapacitet stërvitor e trajnues, që mbështet me programe simuluese zhvillimin e stërvitjeve e trajnimeve kolektive, të mbështetur në praktika të standardizuara, me koston më të ulët, dhe në kohën më të shkurtër të mundshme. Gjithashtu QS ofron ekspertizë dhe mbështetje për planëzimin e stërvitjeve kolektive, një infrastrukturë të përshtatshme për stërvitje optimale për njësi në nivel batalioni, si dhe mbështetjen me materiale stërvitore (radio, harta, shënjes, materiale kancelarie, etj.) për njësitë në stërvitje, etj. Krahas ofertës, QS është këmbëngulëse në kërkesën për të pasur një audiencë stërvitore të përgjegjshme për misionin përkatës individual dhe të motivuar për të mësuar, përmirësuar dhe aftësuar veten nëpërmjet stërvitjeve me simulim.

Në zbatim të misionit të saj, QS është e angazhuar që të ndikojë fuqishëm që në të gjithë sistemin arsimor e stërvitor të FARSH të përdoren strategji e metodologji stërvitore që nxisin aftësitë e të menduarit kritik dhe të menduarit rreth zgjidhjes konkrete të problemeve në mënyrë që të përmbushen kërkesat për përshtatje dhe sukses në mjedisin e ndërlikuar operacional të sotëm.

## SIGURIA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

# Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s viziton Bosnje-Hercegovinën, diskutime mbi sigurinë rajonale

## Dialog konstruktiv dhe bashkëpunimin praktik

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer vizitoi Bosnje-Hercegovinën, më 19-20 korrik 2022, ku zhvilloi takime me anëtarët e Presidencës, ministrin e Mbrojtjes, z. Sifet Podzic dhe shefin e Mbrojtjes, gjeneraljtënant Senad Mašovic. Ai vizitoi gjithashtu Shtabin e Brigadës së Mbështetjes Taktike, Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë dhe Selinë e NATO-s në Sarajevë.

Pas një ceremonie zyrtare nderi, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Bauer zhvilloi një takim me shefin e Mbrojtjes së Bosnjës, gjeneraljtënant Senad Masović. Diskutimet u fokusuan në mjedisin e sigurisë rajonale, konfliktin e vazhdueshëm në Ukrainë dhe rezultatet e Samitit të fundit të NATO-s në Madrid. Admirali Bauer u takua më pas me ministrin e Mbrojtjes Podzic. "NATO dhe Bosnje-Hercegovina kanë një partneritet afatgjatë dhe reciprokisht të dobishëm, të bazuar në dialogun konstruktiv, respektin reciprok dhe bashkëpunimin praktik. Së bashku kontribuojmë në stabilitetin dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor", - theksoi admiral Bauer.

Më vonë, admiral Bauer vizitoi Agjencinë Boshnjake të Inteligjencës dhe Sigurisë, e cila është e ngarkuar me monitorimin e situatës së vazhdueshme të sigurisë në rajon, si dhe kërcënimet e mundshme të sigurisë ndaj vendit, përfshirë terrorizmin, spiunazhin dhe krimin e organizuar. Admirali Rob Bauer vizitoi Shtabin e Brigadës së Mbështetjes Taktike të Bosnjës, zhvilloi një takim me komandantin e saj, kolonelin Jasmin Čajić dhe mori pjesë në një prezantim të aftësive operacionale. "Ne jemi mirënjohës për kontributet e vazhdueshme të Bosnjë dhe Hercegovinës për sigurinë tonë të përbashkët euroatlantike, për shembull, duke kontribuar me trupa në misionet e NATO-s; duke trajnuar trupat e NATO-s dhe Partnerëve gjatë stërvitjes vjetore të gatishmërisë ndaj fatkeqësive; dhe ofrimin e njësjerë të specializuara për asgjësimin e mjeteve shpërthyes dhe Policisë Ushtarake për Forcën e Reagimit të NATO-s", - tha Admirali.

Ai përfundoi programin e tij të me një vizitë në selinë e NATO-s në Sarajevë, misioni kryesor i së cilës është të këshillojë dhe ndihmojë të gjitha institucionet dhe autoritetet e Bosnjë-Hercegovinës mbi reformën e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë dhe aktivitetet e Partneritetit për Paqe të NATO-s (PfP). Në takimin me komandantin e saj, gjeneral brigade Pamela McGaha, admiral Bauer nënvizoi rolin e rëndësishëm që luan Shtabi në rajon. "Misioni i NATO-s në BiH sot është ai i bazuar në partneritet. Ndërsa marrëdhëniet e NATO-s me BiH kanë ndryshuar me kalimin e kohës, angazhimi ynë për të ndihmuar në sjelljen e paqes, sigurisë dhe prosperitetit në rajon nuk ka ndryshuar", - theksoi admiral Bauer.

**Cilat janë marrëdhëniet e NATO-s me Bosnje-Hercegovinën?**

Bosnja dhe Hercegovina aspiron të anëtarësohet në NATO. Mbështetja për reformat demokratike, institucionale, të sektorit të sigurisë dhe të mbrojtjes janë fokusi kryesor i bashkëpunimit. Aleanca ka qenë e angazhuar për ndërtimin e paqes dhe stabilitetit afatgjatë në Bosnje dhe Hercegovinë që nga fillimi i viteve 1990, kur filloi të mbështesë përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për t'i dhënë fund konfliktit në Bosnje dhe Hercegovinë.

NATO luajti një rol kyç në zbatimin e Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit përmes vendosjes së paqes gjatë një periudhe nëntëvjeçare nga dhjetori 1995 deri në dhjetor 2004. Në dhjetor 2004, përgjegjësia kryesore për aspektet ushtarake të Marrëveshjes së Paqes u dorëzua Bashkimit Europian, e cila që atëherë ka kryer operacionin EUFOR Althea në Bosnje dhe Hercegovinë. NATO ofron mbështetje për operacionin EUFOR "Althea" të udhëhequr nga BE sipas Marrëveshjeve të Berlinit Plus.

Bosnja dhe Hercegovina u bashkua



programit të Partneritetit për Paqe (PfP) në vitin 2006 dhe u ftua t'i bashkohej planit të veprimit të anëtarësimit në 2010. Në kuadër të Planit të Veprimit të Anëtarësimit, bashkëpunimi i vendit me NATO-n është i strukturuar përmes Programit të Reformës së Bosnjë-Hercegovinës. Ky Program Reformash përshkruan reformat që qeveria synon të ndërmarrë dhe lehtëson ofrimin e mbështetjes nga NATO drejt këtyre përpjekjeve.

Për të lehtësuar bashkëpunimin, Bosnja dhe Hercegovina ka një mision diplomatik në selinë e NATO-s si dhe një zyrë ndërlidhëse në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Europë (SHAPE).

NATO ka një seli ushtarake në Sarajevë me misionin kryesor për të ndihmuar autoritetet e Bosnjë-Hercegovinës me reformat dhe angazhimet në lidhje me programin e PfP-së dhe integrimin më të ngushtë me NATO-n, si dhe misionin dytësor të ofrimin të mbështetjes logjistike dhe të tjera, për Forcën e Bashkimit Europian në Bosnje dhe Hercegovinë.

Në dritën e pushtimit të përpjekjeve për Paqe të Ukrainës nga Rusia në vitin 2022, NATO po rrit mbështetjen e saj për partnerët, përfshirë Bosnjën dhe Hercegovinën, për t'i ndihmuar ata të ndërtojnë aftësitë e tyre dhe të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre.

Ndërkohë ministri i Mbrojtjes i Bosnje-Hercegovinës ishte i pranishëm në Samitin e NATO-s 2022 në Madrid, ku aleatët u angazhuan për të rritur mbështetjen praktike dhe politike të përshtatur vendin.

**Partneriteti i NATO-s me Bosnje-Hercegovinën**

Bosnje-Hercegovina u ftua t'i bashkohej Planit të Veprimit të Anëtarësimit (MAP) në 2010 dhe prezantoi Programin e saj të parë të Reformës në 2019. Pjesëmarrja në

MAP nuk paragjykon asnjë vendim për anëtarësimin e ardhshëm, por Bosnja dhe Hercegovina duhet të vazhdojë të ndjekë reformat demokratike dhe të mbrojtjes për të përbushur aspiratat e saj në NATO dhe BE dhe për t'u bërë një shtet i pavarur demokratik që funksionon mirë.

Në fillim të vitit 2021, Bosnje-Hercegovina themeloi Komisionin për Bashkëpunim me NATO-n, i cili koordinon zbatimin e aktivitetëve reformues në kuadër të Programit të Reformës. Ndërsa ministri i Mbrojtjes i Bosnje-Hercegovinës mori pjesë në Samitin e NATO-s 2022 në Madrid, aleatët ranë dakord për një sërë masash shtesë politike dhe praktike për të mbështetur Bosnje-Hercegovinën në forcimin e qëndrueshmërisë së saj, përfshirë këtu edhe zhvillimin e një pakete të re për ndërtimin e kapaciteteve të mbrojtjes.

**Fushat kryesore të bashkëpunimit të NATO-s dhe Bosnje-Hercegovinës**

Bashkëpunimi i Bosnje-Hercegovinës me NATO-n është reciprokisht i dobishëm dhe përfshin: 1)Ndërtimin e aftësive dhe ndërveprimit dhe 2) Mbështetje për operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO.

Lidhur me Ndërtimin e aftësive dhe ndërveprimit, Bosnje-Hercegovina po punon për të zhvilluar Forca të Armatosura plotësisht profesionale që janë të ndërveprueshme me forcat e NATO-s dhe që drejtohen nga vullnetarë që plotësojnë standarde të larta profesionale. Për këtë qëllim, vendi ka marrë pjesë në Procesin e Planifikimit dhe Rishikimit të PfP (PARP) që nga maji 2007. Roli i PARP është të sigurojë një bazë të strukturuar për identifikimin e forcave dhe aftësive që mund të jenë në dispozicion të Aleancës për trajnime shumëkombëshe,

ushtrike dhe operacione paqeruajtëse dhe menaxhuese të krizave. Ai shërben gjithashtu si mekanizmi kryesor i përdorur për të udhëhequr dhe matur përparimin e mbrojtjes dhe reformës ushtarake.

Bosnja dhe Hercegovina ka deklaruar një sërë forcash dhe asetesh si potencialisht të disponueshme për aktivitetet e PfP-së, përfshirë aftësitë inxhinierike (depozitimi i mjeteve shpërthyes) dhe pajisjet përkatëse.

Që nga viti 2014, nën Iniciativën e Ndërveprueshmërisë së Partneritetit, Bosnje-Hercegovina ka marrë pjesë në Platformën e Ndërveprueshmërisë, e cila bashkon aleatët me partnerë të përzgjedhur që janë kontribuues aktivë në operacionet e NATO-s.

Bosnja dhe Hercegovina është një pjesëmarrëse aktive në programin e përshtatur Ndërtimi i Integritetit (BI), i cili fokusohet në qeverisjen e mirë dhe përdorimin transparent dhe efektiv të burimeve të mbrojtjes. Qendra e Trajnimit për Operacionet e Mbështetjes së Paqes (PSOTC) e akredituar nga NATO e vendit ofron trajnime ekspertësh mbi ndërtimin e integritetit dhe tema të tjera për NATO-n dhe vendet partnere.

Kurse lidhur me mbështetjen për operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO mund të themi se që nga viti 2009, Bosnje-Hercegovina ka kontribuar me oficerë në Forcën Ndërkombëtare të Asistencës për Sigurinë (ISAF) të udhëhequr nga NATO në Afganistan, si pjesë e kontingjenteve daneze dhe gjermane, dhe gjithashtu kontriboi në misionin e saj pasues të Mbështetjes së Vendosur (RSM).

**Bashkëpunim më i gjerë për anëtarësimin e mundshëm të Bosnje-Hercegovinës në NATO**

Bosnje-Hercegovina aktualisht po zhvillon aftësitë e saj kombëtare për menaxhimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive në konsultim me aleatët, përfshirë zhvillimin e kuadrit ligjor për përbalimin e emergjencave civile dhe punën për krijimin e një sistemi informacioni për krizën civile për të koordinuar aktivitetet në rast emergjence. Në maj 2014, Bosnje-Hercegovina kërkoi ndihmë nga Qendra Euro-Atlantike e NATO-s për Koordinimin e Reagimit ndaj Fatkeqësive (EADRCC) pas përmbyqjes shkatërruese që goditën vendin. NATO koordinoi ndihmën emergjente nga vendet aleate dhe partnere, duke dërguar helikopterë, anije, ujë të pijshëm, ushqim, strehim dhe fonde. Në vitin 2017, vendi priti stërvitjen vjetore të gatishmërisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive EADRCC që mboldhi së bashku aleatët, partnerët dhe organizatat ndërkombëtare.

Bosnje-Hercegovina dhe NATO

synojnë të përmirësojnë aksesin e publikut në informacion mbi përfitimet e bashkëpunimit dhe anëtarësimin e mundshëm të Bosnjë-Hercegovinës në Aleancë. Për këtë qëllim, ekziston një strategji kombëtare e komunikimit e NATO-s. Vëmendje e veçantë i kushtohet aktivitetëve që kërkojnë qëndrueshmëri dhe që lidhin palët kryesore të interesuara: qeveria, shoqëria civile dhe media. Diplomacia publike konsiderohet si një fushë kyçe që ka nevojë për përpjekje dhe burime të përkushtuara për të informuar publikun dhe autoritetet në Bosnje-Hercegovinë për NATO-n. Ekziston nevoja për të ofruar informacion të saktë, për të luftuar dezinformimin dhe për të promovuar përfitimet e përpjekjeve për reforma në Bosnje-Hercegovinë. Selia e NATO-s në Sarajevë siguron burime në terren dhe punon me disa aleatë.

Në kuadrin e Programit të Shkencës për Paqe dhe Siguri (SPS), fushat kryesore për bashkëpunim me Bosnje-Hercegovinën përfshijnë kundër-terrorizmin, mbrojtjen kibernetike, teknologjinë e avancuar, zbulimin dhe pastrimin e minave dhe municioneve të pashpërthyer, si dhe aspektet njerëzore dhe sociale të sigurisë. Veçanërisht, ekspertët nga Bosnje-Hercegovina janë të përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin në të gjithë Ballkanin Perëndimor të Sistemit të Komandës së Incidentit të gjeneratës së ardhshme (NICS), një softuer komandimi dhe kontrolli i bazuar në web që lehtëson bashkëpunimin në të gjitha nivelet e gatishmërisë, planifikimit, reagimit dhe rimëkëmbjen gjatë fatkeqësive natyrore dhe incidenteve të tjera. Përveç kësaj, shkencëtarët dhe hulumtuesit në Bosnje-Hercegovinë po punojnë në zhvillimin e teknologjive të ndryshme për t'u marrë me kërcënimin e rreziqeve shpërthyes, përfshirë përmes realitetit virtual dhe të shtuar dhe sistemeve të zgjeruara të zbulimit.

Bosnje-Hercegovina është prekur ndjeshëm nga pandemia COVID-19. Duke përfaqësuar mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s për vendin, në tetor 2020, aleatët miratuan një paketë ndihme për COVID-19 për Bosnje-Hercegovinën, në shumën prej 500 000 euro, e cila siguronte pajisje mjekësore kritike, përfshirë dhomat e presionit, pajisjet me rreze x, infra të kuqe pa kontakt, termometra, maska, veshje mbrojtëse dhe teste të antigjenit. Në 2021 dhe 2022, mbështetje shtesë u siguroi nga Stoku i Përgjigjes ndaj Pandemisë së NATO-s, i cili përfshinte ventilatorë dhe pajisje mbrojtëse personale. Projektet u zhvilluan bazuar në kërkesën e vendit për ndihmë ndaj Qendrës së Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive Euro-Atlantike të NATO-s (EADRCC).

## TAKIMI I OKB-SË PËR KONTROLLIN E ARMËVE

### NATO ripohon angazhimin e saj të vendosur për të mbështetur kontrollin e armëve

NATO mori pjesë në Takimin e Tetë Dyvjeçar të Shteteve Palë mbi Programin e Punës për të parandaluar, luftuar dhe çrrënjësuar tregtinë e paligjshme të armëve të vogla dhe të lehta, të mbajtur në Nju Jork, nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara.

Vlerësimet e mësipërme të armëve bërthamore janë bërë nga Hans M. Kristensen dhe Matt Korda të Federatës së Shkencëtarëve Amerikanë. Puna e tyre bazohet në arritjet pioniere të analistëve Thomas Cochran, Robert Norris dhe William Arkin. Deklaratat e bëra dhe pikëpamjet e shprehura janë vetëm përgjegjësi e autorëve.

## Efektet e armëve bërthamore

Shpërthimet bërthamore prodhojnë efekte shkatërruese të menjëhershme dhe të vonuara. Shpërthimi, rrezatimi termik dhe rrezatimi i menjëhershëm jonizues shkaktojnë shkatërrim të konsiderueshëm brenda sekondave ose minutave pas një shpërthimi bërthamor. Efektet e vonuara, të tilla si pasojat radioaktive dhe efektet e tjera mjedisore, shkaktojnë dëme për një periudhë të zgjatur që varion nga orë në vite.

## Energjia nga një armë bërthamore

Një nga ndryshimet themelore midis një shpërthimi bërthamor dhe një shpërthimi konvencional është se shpërthimet bërthamore mund të jenë shumë, mijëra (ose miliona) herë më të fuqishme se shpërthimet më të mëdha konvencionale. Të dy llojet e armëve mbështeten në forcën shkatërruese të valës së shpërthimit ose goditjes. Megjithatë, temperaturat e arritura në një shpërthim bërthamor janë shumë më të larta se në një shpërthim konvencional, dhe një pjesë e madhe e energjisë në një shpërthim bërthamor emetohet në formën e dritës dhe nxehtësisë, të referuara përgjithësisht si energji termike. Kjo energji është në gjendje të shkaktojë djegie të lëkurës dhe të ndezë zjarre në distanca të konsiderueshme. Shpërthimet bërthamore shoqërohen gjithashtu nga forma të ndryshme rrezatimi, që zgjasin disa sekonda për të mbetur të rrezikshëm për një periudhë të gjatë kohore.

Përafërsisht 85 për qind e energjisë së një arme bërthamore prodhon shpërthim ajri (dhe goditje), energji termike (nxehtësi). Pjesa e mbetur prej 15 për qind e energjisë lëshohet si lloje të ndryshme rrezatimi bërthamor. Nga kjo, 5 për qind përbën rrezatimi fillestar bërthamor, i përcaktuar si ai i prodhuar brenda një minute apo më shumë pas shpërthimit, janë kryesisht rreze gama dhe neutrone. 10 për qind e fundit e energjisë totale të ndarjes përfaqëson atë të rrezatimit bërthamor të mbetur (ose të vonuar), i cili emetohet gjatë një periudhe kohore. Kjo është kryesisht për shkak të radioaktivitetit të produkteve të ndarjes të pranishme në mbetjet e armëve, ose mbeturinat, dhe mbetjet pas shpërthimit.

“Rendimenti” i një arme bërthamore është një masë e sasisë së energjisë shpërthyes që mund të prodhohet. Rendimenti jepet në terma të sasisë së TNT që do të gjeneronte të njëjtën sasi energjie kur shpërthen. Kështu, një armë bërthamore 1 kiloton është ajo që prodhon të njëjtën sasi energjie në një shpërthim si 1 kiloton (1000 ton) TNT. Në mënyrë të ngjashme, një armë 1 megaton do të kishte energjinë e barabartë me 1 milion ton TNT. Një megaton është e barabartë me 4,18 x 10<sup>15</sup> xhaul.

Në vlerësimin e fuqisë shkatërruese të një sistemi armësh, është zakon të përdoret koncepti i megatonëve ekuivalent (EMT). Megatonazhi ekuivalent përkufizohet si megatonazhi aktual i ngritur në fuqinë dy të tretat:

Kjo lidhje lind nga fakti se fuqia shkatërruese e një bombe nuk ndryshon në mënyrë lineare me rendimentin. Vëllimi në të cilin shpërndahet energjia e armës ndryshon si kubi i distancës, por zona e shkatërruar ndryshon në katrorin e distancës.

Kështu, 1 bombë me rendiment 1 megaton do të shkatërronte 80 milje katrore. Ndërsa 8 bomba, secila me rendiment prej 125 kilotonësh, do të shkatërronin 160 milje katrorë. Kjo marrëdhënie është një arsye për zhvillimin e sistemeve të shpërndarjes që mund të mbajnë koka të shumta luftarake (MIRV).

## Efektet themelore të armëve bërthamore

Shpërthimet bërthamore prodhojnë efekte shkatërruese të menjëhershme dhe të vonuara. Shpërthimi, rrezatimi termik dhe rrezatimi i menjëhershëm jonizues shkaktojnë shkatërrim të konsiderueshëm brenda sekondave ose minutave pas një shpërthimi bërthamor. Efektet e vonuara, të tilla si pasojat radioaktive dhe efektet e tjera të mundshme mjedisore, shkaktojnë dëme për një periudhë të zgjatur që varion nga orë në vite. Secili prej këtyre efekteve llogaritet nga pika e shpërthimit.

### Pika zero

Termi “pika zero” i referohet pikës në sipërfaqen e tokës menjëherë nën (ose sipër) pikës së shpërthimit. Për një shpërthim mbi (ose nën) ujë, pika përkatëse quhet përgjithësisht “sipërfaqja zero”. Termi “sipërfaqja zero” ose “sipërfaqja e tokës zero” përdoret gjithashtu zakonisht për shpërthimet në sipërfaqe dhe nëntokë. Në disa botime, toka (ose sipërfaqja) zero quhet “hipoqendra” e shpërthimit.

### Efektet e shpërthimit

Dëmet më të mëdha vijnë nga shpërthimi i eksplozivit. Vala goditëse e ajrit rrezaton nga jashtë, duke prodhuar ndryshime të papritura në presionin e ajrit që mund të shtypin objektet dhe erëra të forta që mund të rrezojnë objektet. Në përgjithësi, ndërtesat e mëdha shkatërrohen nga ndryshimi i presionit të ajrit, ndërsa njerëzit dhe objektet si pemët dhe shtyllat e shërbimeve shkatërrohen nga era.

Madhësia e efektit të shpërthimit lidhet me lartësinë e shpërthimit mbi nivelin e tokës. Për çdo distancë të caktuar nga qendra e shpërthimit, ekziston një lartësi optimale e shpërthimit që do të prodhojë ndryshimin më të madh në presionin e ajrit, të quajtur mbipresion, dhe sa më e madhe të jetë distanca aq më e madhe është lartësia optimale e shpërthimit. Si rezultat, një shpërthim në sipërfaqe prodhon mbipresionin më të madh në intervale shumë të afërta, por më pak mbipresion sesa një shpërthim ajri në intervale disi më të gjata.

Kur një armë bërthamore shpërthehet në ose afër sipërfaqes së Tokës, shpërthimi gjëmon një krater të madh. Një pjesë e materialit që përdoret në një krater është depozituar në buzë të kraterit; pjesa tjetër bartet në ajër dhe kthehet në Tokë si rrjedhje radioaktive. Një shpërthim që është më larg mbi sipërfaqen e Tokës se rrezja e topit të zjarrit nuk gjëmon një krater dhe prodhon mbetje të menjëhershme të papërfillshme. Në pjesën më të madhe, një shpërthim bërthamor vret njerëzit me mjete indirekte dhe jo me presion të drejtpërdrejtë.

### Efektet e rrezatimit termik

Përafërsisht 35 për qind e energjisë nga një shpërthim bërthamor është një shpërthim intensiv i rrezatimit termik, d.m.th., nxehtësisë. Efektet janë të ngjashme me efektin e një blicë prej dy sekondash nga një llambë e madhe dielli. Meqenëse rrezatimi termik udhëton afërsisht me shpejtësinë e dritës, ndërsa dritës dhe nxehtësisë i paraprijnë valës së shpërthimit me disa sekonda, ashtu si rrufeja shihet përpara se të dëgjohet bubullima.

Drita e dukshme do të prodhojë “verbëri” tek njerëzit që po shikojnë në drejtim të shpërthimit. Verbëria mund të zgjasë për disa minuta, pas së cilës shërimi është total. Nëse drita fokusohet përmes thjerrëzave të syrit, do të rezultojë një djegie e përhershme e retinës. Në Hiroshima dhe Nagasaki, kishte shumë raste të verbërisë, por vetëm një rast i djegies së retinës, midis të mbijetuarve. Nga ana tjetër, kushdo që verbërohet gjatë drejtimit të një makine mund të shkaktojë lehtësisht lëndime të përhershme për veten dhe të tjerët.

Djegjet e lëkurës vijnë nga intensitetet më të larta të dritës, dhe për këtë arsye ndodhin më afër pikës së shpërthimit. Djegjet e shkallës së parë, të dytë dhe të shkallës së tretë mund të ndodhin në distanca prej pesë miljesh larg nga shpërthimi ose më shumë. Djegjet e shkallës së tretë mbi 24 për qind të trupit, ose djegjet e shkallës së dytë mbi 30 për qind të trupit, do të rezultojnë në tronditje serioze dhe ndoshta do të rezultojnë fatale nëse nuk ofrohet kujdes i shpejtë dhe i specializuar mjekësor. E gjithë Shtetet e Bashkuara kanë lehtësira për të trajtuar 1000 ose 2000 raste të djegies së rëndë. Një armë e vetme bërthamore mund të shkaktojë më shumë se 10 000.

Rrezatimi termik nga një shpërthim bërthamor mund të ndezë drejtpërdrejt materialin ndezës. Në përgjithësi, materialet e ndezshme jashtë shtëpisë, të tilla si gjetet ose gazetat, nuk janë të rrethuara nga materiale të djegshme të mjaftueshme për të gjeneruar një zjarr të vetëqëndrueshëm. Zjarret me më shumë gjasa për t'u përhapur janë ato të shkaktuara nga rrezatimi termik që kalon nëpër dritare për të ndezur shtrëtitë dhe mobiliet e tejmblushura brenda shtëpi. Një burim tjetër i mundshëm i zjarreve, që mund të jetë më i dëmshëm në zonat urbane, është indirekt. Dëmtimi nga shpërthimi i dyqaneve, ngrohësve të ujit, furrave, qarqeve elektrike ose linjave të gazit do të ndezë zjarret ku karburanti është i bollshëm.

### Efektet e drejtpërdrejta të rrezatimit bërthamor

Rrezatimi i drejtpërdrejtë ndodh në momentin e shpërthimit. Mund të jetë shumë intensiv, por diapazoni i tij është i kufizuar. Për armët e mëdha bërthamore, diapazoni i rrezatimit të drejtpërdrejtë intensiv është më i vogël se diapazoni i shpërthimit vdekjeprurës dhe efekteve të rrezatimit termik. Megjithatë, në rastin e armëve më të vogla, rrezatimi i drejtpërdrejtë mund të jetë efektiv vdekjeprurës me rrezen më të madhe. Rrezatimi i drejtpërdrejtë shkakto dëme të konsiderueshme për banorët e Hiroshimës dhe Nagasakit. Reagimi i njeriut ndaj rrezatimit jonizues është subjekt i pasigurisë së madhe shkencore dhe polemikave intensive. Duket e mundshme që edhe dozat e vogla të rrezatimit të bëjnë ndonjë dëm. Rrezatimi i rrjedhës merret nga grimcat që bëhen radioaktive nga efektet e shpërthimit, dhe më pas shpërndahen në distanca të ndryshme nga vendi i shpërthimit. Ndërsa çdo shpërthim bërthamor në atmosferë prodhon disa pasoja, rënia është shumë më e madhe nëse shpërthimi është në sipërfaqe, ose të paktën aq i ulët sa zjarri të prehtë tokën. Rreziqet e rëndësishme vijnë nga grimcat e mbledhura nga toka dhe të rrezatuara nga shpërthimi bërthamor. Grimcat radioaktive që ngrihen vetëm në një distancë të shkurtër (ato në “rrjedhën” e resë së njohur të kërpudhave) do të bien përsëri në tokë brenda pak minutash, duke u ulur afër qendrës së shpërthimit. Grimca të tilla nuk kanë gjasa të shkaktojë shumë vdekje, sepse ato do të bien në zonat ku shumica e njerëzve tashmë janë vrarë. Megjithatë, radioaktiviteti do të komplikojë përpjekjet për shpëtim ose rindërtim eventual. Grimcat radioaktive që ngrihen më lart do të barten në një distancë nga era përpara se të kthehen në Tokë, dhe për këtë arsye zona dhe intensiteti i rënies ndikohet fuqishëm nga kushtet lokale të motit. Pjesa më e madhe e materialit thjesht fryhet nga era në një shtëllungë të gjatë. Reshjet gjithashtu mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në mënyrat se si depozitohet rrezatimi nga armët më të vogla, pasi shiu do të sjellë grimcat të kontaminuara në tokë.

Zonat që marrin reshje të tilla të kontaminuara do të shndërrohen në “pika të nxehta”, me intensitet më të madh rrezatimi sesa rrethinat e tyre.

# IDENTITETI KOMBËTAR AUTENTIK SHQIPTAR

Trashëgimia kulturore përfshin pasurinë kulturore materiale dhe jo materiale, të luajshme dhe të paluajshme, si një tërësi vlerash kulturore mbartëse të kujtesës historike dhe identitetit kombëtar, si dhe me rëndësi shkencore dhe kulturore.

Veshja është një nga elementet më të rëndësishëm të artit popullor. Veshjet karakterizohen nga një bukuri artistike dhe ndryshojnë sipas krahinës dhe gjinisë. Veshjet popullore krahasohen me gjuhën shqipe dhe traditat e tjera kulturore, ato paraqesin histori në vetvete.

Kostumografia është një simbolikë krahinore, veshjet janë ruajtur dhe përshtatur deri në kohët e sotme nga Jugu në Veri. Veshjet janë thesar i paçmuar për traditën kulturore të popullit tonë. Veshjet i ndajmë në të Shqipërisë së Veriut, Shqipërisë së Mesme dhe Shqipërisë së Jugut.

## Karakteristikat e veshjes popullore të Veriut:

Xhubletë, pantallona, shajaku, opinga me majë, zburime te femrat.

## Karakteristikat e veshjes popullore të Shqipërisë së Mesme:

Citjane, takie, jelek i qëndisur me fije ari, kapela e qëndisur, zburime në kokë.

## Karakteristikat e veshjes popullore të Jugut:

Fustanellë, qeleshe, opinga me xhufka, përparëse e qëndisur.

Veshjet karakterizohen nga një bukuri artistike dhe ndryshojnë sipas krahinës dhe gjinisë. Veshjet popullore krahasohen me gjuhën shqipe dhe traditat e tjera kulturore, ato paraqesin histori në vetvete. Kostumografia është një simbolikë krahinore, veshjet janë ruajtur dhe përshtatur deri në kohët e sotme nga jugu në veri. Veshjet janë thesar i paçmuar për traditën kulturore të popullit tonë.



Mund të përmendim kështu analogjitë e vërejtura midis linjës popullore dhe “dalmatikës” ilire, apo midis kapuçave, strukave (shalleve), opingave, etj. dhe elementeve respektivë, të përdorur nga ilirët. Falë këtyre elementeve të trashëguar nga kultura ilire dhe ajo e arbërve të mesjetës, gjatë zhvillimit të tyre historik, veshjet popullore kanë arritur të fitojnë një varg tiparësh origjinalë, që marrin vlerat e një treguesi etnik, i cili i dallon veshjet shqiptare nga ato të popujve të tjerë.

E merr këtë emër nga një lloj fundi në formë kambane të valëzuar, i qepur me rripa prej shajaku të vendosur njëri pas tjetrit në linjë horizontale, bashkimi i të cilëve realizohet me gajtanë të hollë prej leshti. Xhubleta shoqërohet edhe me disa pjesë të tjera prej shajaku me ngjyrë të zezë, si të xhubletës të cilat quhen grykës, mange, dhe krahol. Pjesë tjetër është edhe brezi i gjerë i zburuar me rruaza dhe gajtanë, i cili në të folurën vendore quhet kerrdhokoll. Në kokë mbahej një shami e bardhë, e lëshuar mbi shpatullat. Këmbët mbroreshin me kellei shajaku ose me çorapë të gjata si dhe me opinga lëkure. Veshja me xhubletë në gjysmën e poshtme ka formën e kambanës dhe në gjysmën e sipërme ngjan me veshjen e kryqtarëve, sikundër dhe mjaft simbole të gdhendura mbi këtë kostum, si koka e demit kretan, forma kryqi, svastike, etj., janë të njohura si të templarëve.

Misteri i veshjes së zezë shkelqen nga të gjitha pikëpamjet, si nga ndërtimi, teknika e endjes, ornamentikës së qëndisjeve, derdhjes së stolive, etj. Misteri i veshjes së zezë është më i madh se dija mbi përmbajtjen e saj. Në këtë veshje bie në sy forma e xhubletës, krejt e veçantë nga çdo veshje tjetër, mënyra e zburimit të pjesëve të saj me motive dhe ngjyra të plota, por shumë të zgjedhura; si ngjyra e zezë, ciklamini, vjollcë ose blu. Kjo veshje është mbajtur në të gjitha malësitë e Alpeve të Shqipërisë përfshirë edhe pjesën e Alpeve në Malin e Zi. Xhubleta përfaqëson veshjen më të hershme në Shqipëri dhe në Ballkan, ajo sjell mesazhet e qytetërimin ilir në kulturën popullore shqiptare.

Pjesë kryesore e kësaj veshjeje është këmisha e gjatë, me mëngë të gjata, të gjera ose të ngushta. Në mes ajo shtrëngohet nga një brez leshti me ngjyra të ndryshme dhe shoqërohet në pjesën e përparme nga një përparëse e leshtë ose e pambuktë me madhësi e zburime që ndryshonin nga njëra krahinë në tjetrën. Në stinë e verës, në pjesën e sipërme gruaja e veshur me këtë këmishë mbannte një jelek, kurse në dimër sipër tij shtohet edhe një mitan me mëngë të gjata si dhe një xhokë prej shajaku. Gjatësia, ngjyra dhe zburimi i xhokës ndryshonte veçanërisht nga pozita gjeografike apo zhvillimi i krahinave ku mbahej kjo veshje, duke krijuar kështu veçori të shumta lokale. Kjo veshje qe e përhapur në Mirditë, Dibër, Mat, Shtat, Çermenikë, Dumre, Myzeqe, Berat, Korçe, Kolonjë, Gjirokastrë, Sarandë etj.

Edhe kjo veshje përbëhej nga një këmishë e gjatë, jelekun apo mitanin, brezi disa ngjyrësh, porse shoqërohej edhe me dy futa të gjata (përparje), njëra e ngjeshur në pjesën e përparme dhe tjetra pak më e vogël vendosje prapa. Në këtë variant (të gjata) ishin përparjet (futat) që mbanin gratë e Postribës (Shkodër) ato të fshatrave Baz, Vinjoll, Karrice etj., të rrethit të Matit. Në një variant tjetër futat kishin formë trapezi dhe ajo që vihej përpara ishte më e madhe dhe quhej paraniq, ndërsa e pasmja kishte përmasa më të vogla dhe quhej mbrapanik. Ky variant ishte i përhapur në disa fshatra të rrethit të Pukës, në Malësinë e Gjakovës (rrethi Tropojë), në disa fshatra të rrethit të Hasit, si dhe në disa fshatra të Rrafshit të Dukagjinit (Kosovë). Futat kishin formë katërkëndëshe, gjithashtu edhe në këto krahina ajo që vihej përpara ishte më e madhe se e pasmja. Si në variantin e dytë edhe në të tretin, ato prej leshti pëlqeshin në ngjyra të errëta (të zezë, kafe ose vishnje).

Pjesë kryesore në këtë tip veshjeje është një lloj fundi i gjerë, me pala të vogla. Nën të vishej një këmishë e ngushtë, kurse në pjesën e sipërme vishej jeleku dhe një si fanellë me mëngë të ngushta. Në fshatrat e krahinës së Zadrimes mbahej një variant mbështjellëseje, palat e së cilës vendoseshin vetëm në pjesën e pasme të trupit. Zakonisht ajo kishte ngjyrë të zezë. Në disa fshatra të Pukës dhe të Malësisë së Gjakovës, mbështjellësja, e cila zakonisht kishte ngjyrë vishnje ose të gjelbër dhe më rrallë ngjyrë vjollcë, kishte një pamje mjaft elegante dhe shoqërohej me çorapë të leshta të zburuar me disa motive disangjyrëshe. Ndërsa varianti i mbajtur në disa fshatra të krahinës së Lumës (Kukës) dhe ai i mbajtur në Shishtavec (Kukës) shoqërohej me mbathje të gjata, këmbëzat e të cilave bëheshin të gjera dhe prej leshti të punuara me ngjyra të ndryshme.

Emërtimi i këtij tipi përcaktohet nga një lloj pantallonash shumë të gjera dhe me ngjyrë të zezë. Në pjesën e sipërme të trupit gratë e veshura me brekushe vishnin këmishë të shkurtër, jelek ose mitan. Në këmbë mbahtin dhe çorapë leshti me shumë ngjyra. Gjithnjë mbi brekushe në pjesën e përparme vishej edhe një përparje prej leshti e zburuar me kuadrat disa ngjyrëshe. Ndërsa në kokë mbanin shamia shumëngjyrëshe të lidhura nën gushë, palosur në formë treëndëshe. Në fakt kjo veshje është futur në përdorim nga fillimi i shek. XX dhe pati përdorim të kufizuar, kryesisht në disa fshatra të Malësisë së Tiranës, në Martanesh, në Polis, Bërzhë, Gur i Bardhë etj.

Pjesët më të rëndësishme të kësaj veshjeje për burra janë: këmisha me ngjyrë të bardhë si dhe dollomaja ose cibuni i gjatë prej shajaku. Në stinë e verës në vend të dollomasë vishej një lloj xhamadani prej shajaku. Nën këmishë visheshin mbathje të gjata të shoqëruara me kelleinje. Dollomaja apo cibuni paraqitet me disa ndryshime në zona të ndryshme. Diku ishte e gjatë deri mbi gju, diku tjetër deri në pulpat e këmbës. Diku me ngjyrë të bardhë dhe e zburuar me gajtanë të zinj, e diku me ngjyrë të zezë. Kjo veshje është përdorur në Mirditë, Mat, në Dibër, në Malësi të Madhe, në Korçë, Kolonjë, Gjirokastrë etj. Mbas Luftës II Botërore ky tip veshjeje u zëvendësua me veshjen me tire. Dollomaja vazhdoi të

mbahet si veshje ceremoniale e veshur mbi tire ose përdoret në raste kuvendesh.

Elementi më tipik i kësaj veshjeje janë tirat që cilët kanë formën e pantallonave të ngushta prej shajaku (më të shumtën e rasteve të bardhë dhe më rrallë të zi ose të murrme). Përgjithësisht ato lidhen poshtë belit (në kërdhokull) shoqëruar edhe me një brez të leshtë me vija disangjyrëshe. Në pjesën e sipërme vishej një këmishë me mëngë të gjata, jelek pa mëngë dhe xhamadan me mëngë të gjata, të dy prej shajaku. Në stinë të ftohta mbi xhamadan vishej edhe një xhakëtë me mëngë të shkurtër dhe me jakë marinari (prej shajaku me ngjyrë të zezë) e quajtur diku xhurdi, diku tjetër kaporane ose herke. Tirat zakonisht janë mbajtur në Shqipërinë veriore, në Kosovë dhe në Shqipërinë verilindore, duke arritur deri në rrethin e Beratit.

Edhe në këtë tip veshjesh emërtimi lidhet me pjesën e poshtme të veshjes, e cila ka formën e pantallonave të gjera, të bëra me pëllurë leshti ose pambuku të endura në avlëndend shtëpiak. Gjithmonë ato ishin të gjata deri në njërin e këmbës si dhe shoqëroheshin me një brez të gjerë leshti me ngjyrë të kuqe në vishnje. Në pjesën e sipërme të trupit vishej këmishë me mëngë të gjata dhe të ngushta. Në stinë e ftohta përveç jelekut e xhamadani prej shajaku, vishej edhe jakucja me xhufka (një lloj xhakete me mëngë të shumta). Kjo veshje është përdorur në fshatrat e Zadrimes (në stinë të ngrohta) në Shqipërinë e Mesme dhe disa fshatra të Matit, Martaneshit, Mirditës, Librazhdit, Çermenikës etj.

Veshje me tirq. Ndryshe nga veshjet e tjera, këto lloj pantallonash kanë mjaft ndikim (në formën e prerjes) nga e njëjta veshje e përdorur në vendet orientale. Në pjesën e poshtme të këmbëve (poshtë gjurit) visheshin kalce prej shajaku. Ndërsa në pjesën e sipërme vishej këmisha me mëngë të gjata e shoqëruar me një jelek prej shajaku, i cili mbërthehej në pjesën anësore të gjoksit. Në stinë të ftohtë vishej dhe një xhamadan me mëngë që i vasheshin në pjesën e pasme të trupit. Kjo veshje kishte edhe një pjesë tjetër që dallonte nga krahinat e tjera, është pikërisht qelesha e lartë ose takija gjysmë sferike. Kjo veshje ka pasur përhapje të kufizuar, kryesisht në Labëri, Mallakastër, Myzeqe etj. Poturet kanë zëvendësuar veshjen me fustanellë aty nga fundi i shek. XIX. Veshje popullore burrash në vise të ndryshme, në JUG dhe VERI. Fustanella ka trajtën e një fundi të gjerë, me shumë kinde (pala) në formë trapezi, të qepura së bashku e të mbledhura me rruadha të dendura tek beli. Copa ishte pëllurë shtëpiake e bardhë prej pambuku e liri. Kostumi me fustanellë përbëhet nga këmisha, fustanella, tirqi/kalce, brezi, jeleku dhe xhamadani. Luftëtar të ndryshëm kanë veshur edhe fustanellë të murrme dhe të zezë. Fustanella është veshje që i përket një kohe shumë të vjetër. Dokumentohet të jetë që nga shek. IV - III para erës sonë, në disa gjetje arkeologjike. Veshje tipike e grave në Shqipërinë veriore, mbi lumin Drin, Nikaj-Mertur e Rugova, Malësi e Madhe dhe shqiptar të Malit të Zi. Në zonën e Nënshkodrës e deri në Breg të Matës, ku malësorët e Malësisë së Madhe ranë. Xhubleta është një fund në trajtë kambane, që vjen i valëzuar për fundi, sidomos në pjesën e pasme. Bëhej nga një numër i madh copash e rripash të ngushtë shajaku, të vënë horizontalisht dhe të ndërthurura me breza gajtanësh. Mbahet e varur në supë me dy rripa të gjerë. Në shek. XVIII, xhubleta bëhej me shumë ngjyra, por ngjyrat që kanë arritur në ditët e sotme janë: të zeza për gratë dhe bardh e zi për vajzat. Pjesë të tjera të kostumit me xhubletë janë: kraholin, xhoka, kërdhokla, paraniku, kallmat e shputat, etj. Xhubleta është me prejardhje të lashtë. Paraqet ngjashmëri me veshjen e disa figurinave neolitike të gjetura në Bosnje, por edhe në vise të tjera të Mesdheut, që i përkasin mijëvjeçarit të dytë para erës sonë dhe lidhen me qytetërimet e vjetra mesdhetare.

XHUBLETA e MALSISË së MADHE është trashëgimi më i qartë i kulturës tonë Iliriane, ku vetëm nëpërmjet saj në paraqesim historinë e humbur të kombit tonë, që malësoret tona e përcollën deri në vitet 1950 - 1960, pra e vetmja që jep identitetin e kombit shqiptar, nëpërmjet motiveve, ku emblema më e dukshme për të gjitha është shqiponja. Në misterin e xhubletës janë një seri simbolesh ku paraqesin lidhjet me fenë katolike, besimin të zoti, dashurinë dhe bukurinë e femrës malësore.

Pjesë përbërëse e veshjes popullore me traditë të vjetër dhe shtrirje mbarë shqiptare. Llojet më të thjeshta bëheshin prej një cope të vetme lëkure në trajtë katërkëndëshe kënd-drejtë, buzët e së cilës rrudheshin me retre lëkure duke u afruar pak këmbës e pastaj shtrëngoheshin me gjalma prej leshti. Sipas mënyrës se si qepjej maja, si visheshin rripat e gjuhëza ose si thurej faqja e sipërme e opingës e si zburuhohej ajo, dalloheshin variante të shumta: opinga lope, me retre, me gjuhëzë, opinga me përkresa, me tufëza, me xhufka, opinga me prroqe etj. Dëshmitë më të hershme arkeologjike për opingat u përkasin shek. V-IV para erës sonë. Veshje dimri, në formë manteli të gjerë prej leshti, me mëngë dekorative (që nuk visheshin) dhe me kapuç për kokë. Njiihej me disa emra: gunë çile (e dhirte) për barinjët, gunë larë ose laroshe, tallagane, tamare etj. Të ngjashme nga funksioni dhe nga materiali, por në formë pelerine, ishin disa veshje të tjera dimri që përdoreheshin në zona të ndryshme të vendit si: bërruci e sharku në Labëri, japaxhja e bardhë e burrave në Kosovë, tallagani i grave në Malësinë e Madhe etj. Veshjet popullore, dhe pse një vlerë shumë e madhe artistike dhe kulturore për ne, me kalimin e kohës dhe me ndryshimet e saj filluan të ndryshojnë dhe si të tilla në shumë pak vende sot vishen akoma. Kohët e fundit vëmë re një risi që ka filluar të frekuentohet shumë në dasmat dhe nga nuset e sotme. Tashmë ato parapëlqejnë që në ditën e dasmës së tyre një nga veshjet të jetë dhe një me motive popullore nga krahina nga ato vijnë. Këto veshje cilësohen të veçanta për to dhe mbeten një dhuratë shumë e bukur dhe një suvenir i rëndësishëm në pajtën e tyre. Mund të themi që edhe sot, edhe pse në raste të tilla, domethënë në martesë, veshjet popullore përdoren dhe me këtë themi që ato nuk janë zhdukur por vazhdojnë të jenë në kulturën tonë si diçka e vyer dhe me shumë vlerë.



Llojet kryesore të veshjeve popullore shqiptare për burra janë: kostumi me fustanellë, kostumi me këmishë të gjatë e dollamë (cibun), sipër kostumi me tirq dhe ai me poture (pantallona të shkurtra deri te gjuri). Pra, në Shqipëri, burrat kanë mbajtur si veshjet në formën e një fundi të gjerë, ashtu edhe ato në formë pantallonash, por të parat kanë dalë nga përdorimi më herët se të tjerat. Pjesët më të zburuara ishin jelekët dhe xhamadani e kostumit festiv. Burrat shqiptarë mbanin edhe stoli të ndryshonin sipas moshës. Për të vegjëlit e rinjtë, kostumi krahinor mund të ishte më i thjeshtë. Ndryshe nga popuj të tjerë të Ballkanit, në Shqipëri vajza që kishte arritur moshën e martesës duhet të vishej thjeshtë e pa stoli, flokët t'i mbulonte mirë me një shami dhe të mos vishte rrobë të kuqe. Kostumi i martesës ishte varianti më i pasur i veshjes së krahinës, si për nuset edhe për dhëndurët. Për nuset, stolitë metalike ishin të pamungueshme, madje, përdoreheshin edhe me tepri, sepse këtu, me sa duket, kishte rëndësi jo vetëm funksioni i tyre estetik, por edhe funksioni magjik që u atribuoheshin. Për nuset, rëndësi të veçantë kishte zburimi i kokës. Disa vjet pas martesë, veshja fillonte të lehtësohej nga zburimi.

Për gra, tipat kryesore të veshjeve, ishin: kostumi me xhubletë (një fund në formë kambane), kostumi me këmishë të gjatë e xhokë shajaku sipër, kostumi me dy futa të vendosura mbi këmishën e gjatë, njëra përpara e tjetra prapa dhe kostumi me mbështjellëse (një fund i hapur, i mbledhur tek beli me rruadha ose pala). Në veshje, ngjyrat e zburimit ndryshonin sipas moshës. Për të vegjëlit e rinjtë, kostumi krahinor mund të ishte më i thjeshtë. Ndryshe nga popuj të tjerë të Ballkanit, në Shqipëri vajza që kishte arritur moshën e martesës duhet të vishej thjeshtë e pa stoli, flokët t'i mbulonte mirë me një shami dhe të mos vishte rrobë të kuqe. Kostumi i martesës ishte varianti më i pasur i veshjes së krahinës, si për nuset edhe për dhëndurët. Për nuset, stolitë metalike ishin të pamungueshme, madje, përdoreheshin edhe me tepri, sepse këtu, me sa duket, kishte rëndësi jo vetëm funksioni i tyre estetik, por edhe funksioni magjik që u atribuoheshin. Për nuset, rëndësi të veçantë kishte zburimi i kokës. Disa vjet pas martesë, veshja fillonte të lehtësohej nga zburimi.



Në veshjet popullore, shenjat e zisë ishin të pakta, gratë mund të vishnin praptas ndonjë nga pjesët më të zburuara të kostumit, p.sh. xhokën e përparjen. Studimet e deritanishme, kanë treguar se pjesët përbërëse të veshjeve tradicionale, nuk kanë të gjitha të njëjtën moshë. Ka pjesë, që të kujtojnë veshjet mesjetare, me ndikime bizantine e orientale, të tjera që vijnë si një jehonë e kohës antike, por ka edhe elementë, që mund të lidhen me kulturën ilire.





PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

# Vlerat e Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ-it

*(Në kuadrin e 65-vjetorit të krijimit të kësaj organizate)*

## Organizata që mbron vlerat luftarake të popullit

Populli shqiptar në shekuj ka bërë përpjekje të vazhdueshme për dinjitet, pavarësi, liri dhe demokraci. Akumulimi i këtyre principeve parimore mori vlerë dhe u ngrit në shkallë më të lartë në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Lufta dhe kontributi i luftëtarëve shqiptarë filloi më 7 prill 1939 dhe përfundoi më 29 nëntor 1944, kur u çlirua vendi nga pushtuesit nazifashistë. Lufta e drejtë për çlirim dhe liri, bëri që Shqipëria të rreshtohet me plot dinjitet në Koalicionin e madh Antifashist Botëror, ku dha kontribut dhe shfaqti vlera, si një vend që u përball me dy fuqi të mëdha pushtuese të kohës dhe doli fitimtare në çlirimin e vendit me forcat e veta.

Luftëtarët e kësaj lufte heroike, më 20 korrik 1957, krijuan Organizatën e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, për të mbajtur gjallë frymën atdhetare dhe për të përkujtuar dhe transmetuar në breza këtë përvijë të madhe luftarake. Rrënjët e saj fillojnë me rezistencën popullore, organizimin luftarak dhe luftën kundër pushtuesit të huaj, çlirimin e vendit dhe sot mbrojtjen e idealeve të shenjta të LANÇ-it. Për këto ideale veteranët, por sidomos në këto vite të Demokracisë, kanë bërë sakrificat edhe më të mëdha se sa edhe në luftë. Ata u përballën me reaksionin e egër, që donte të çmontonte këto vlera të lavdishme të popullit tonë. Organizata e Veteranëve të LANÇ-it përfaqëson dhe është një organizatë e masive luftëtare, e pavarur, pluraliste dhe joqeveritare. Veprimtarinë e saj e zhvillon me iniciativë të plotë, krejtësisht të pavarur e në bazë të ligjeve të shtetit. Këtë e vërteton gjithë lufta e bërë në këto vite për mbrojtjen e vlerave luftarake të popullit, gjakun dhe sakrificat e luftëtarëve të brigadave sulmuese dhe dëshmorëve e heronjve të rënë, për mbrojtjen e simboleve, nga nëpërkëmbja e tyre prej politikës së mbrapshtë dhe të pa orientuar drejt vlerave të lirisë dhe të antifashizmit. Veteranët dhe organizata e tyre luftuan në çdo ditë për t'i ruajtur dhe për t'i shtuar edhe më shumë këto vlera, dhe nuk pushuan e nuk u nënshtruar, por dëshmuar për historinë dhe sakrificat e një populli të vogël të bërë në luftë kundër armikut dhe tradhtarëve të vendit.

Organizata e Veteranëve, si bashkimi i të gjithë veteranëve dhe i pasardhësve të tyre, u organizua dhe u shtri në të gjithë territorin e Shqipërisë, edhe në fshatin më të largët e më të thellë të vendit. Në radhët e saj ajo pranon, respekton dhe vlerëson bindjet politike, fetare, krahinore dhe gjinore, ndaj dhe është e kudogjendur me autoritetin e saj dinjitoz. Këtë



vend të respektuar e ka bërë me punë dhe me përpjekje për të demonstruar anët më pozitive dhe më patriotike të popullit, për të ruajtur dinjitetin dhe sakrificat e treguara në luftë. Organizatë plot dinjitet dhe krenari

Veterani i LANÇ-it shfaqet plot dinjitet dhe krenari të pamohueshme për vlerat e luftës, të gjakut të dëshmorëve dhe të sakrificave të një populli heroik. Veterani ngelet figurë nderi e popullit shqiptar dhe e Atdheut. Gjithë sakrificat dhe përpjekjet e tij, vërtet gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore, por ende qeveria dhe shoqëria, nuk i kanë vendosur në pedestalin e nderit, siç kanë bërë kombe dhe vende të përparuara të demokracisë në botë. Ata ende sot janë të braktisur, kanë një seli që ngjitet disa shkallë për të mbërritur në katin e pestë të një godine që pa frikë mund të quhet muze, ndërsa ana tjetër godina shkëlqen me të gjitha komoditetet më të mira...

Veteranët dhe organizata e tyre janë parimor dhe të vëmendshëm, njohin dhe respektojnë partitë, organizatat dhe shoqatat e tjera të cilat i vlerësojnë dhe pranojnë vlerat e pamohueshme të LANÇ-it të Popullit Shqiptar. Në këtë periudhë të demokracisë, veteranët e kanë ngritur zërin kundër forcave revenshiste të përkrahura dhe nga forca të caktuara politike të cilat prishën përmendore dhe lapidarë, vunë dorë në Varrezat e Dëshmorëve, thyen pllaka përkujtimore dhe nëpërkëmbën simbolet e luftës, ato simbole që na radhitën me fitimtarët në botë. Organizata në

këto vite të jetës së saj 65-vjeçare, ka ditur më së miri të mbrojë dhe të propagandojë, të ruajë dhe të mbajë gjallë traditat e LANÇ-it. Ajo më së miri i ka transmetuar këto vlerave të pasardhësve të tyre. Kurrë nuk është lodhur së bashkëpunuari me pushtetin vendor dhe qendror, me shoqata patriotike e kulturore, me anëtar të e saj për të organizuar e përkujtuar ngjarje dhe data historike të LANÇ-it, si dhe të bëjë promovimin e vlerave të kësaj lufte epope.

Në këto vite lufte dhe jetese, organizata ka mbartur dhe përçar traditat historike e përparimtare të popullit shqiptar, i ka gërshtuar këto tradita patriotike në të gjitha kohërat, si dhe ka vepruar me historinë e popullit shqiptar si një e tërë. Kush më mirë se kjo organizatë i ka ruajtur dhe lartësuar këto vlera, sa Organizata e Veteranëve dhe tashmë edhe e pasardhësve.

Organizata me sakrificat dhe më vetëmohim ka mbajtur gjallë frymën e dashurisë dhe respektin e popullit për bijtë dhe bijat e tij, të cilët dhanë gjithçka për çlirimin dhe lirinë e popullit. Ajo i ka mbrojtur heronjtë dhe dëshmorët e vendit më një përkushtim të madh dhe vetëmohim, duke u ngritur kundër të gjitha shpifjeve dhe shantazheve, denigrimeve dhe përbaltjes së tyre nga forca regresiste dhe prishëse të simboleve të luftës.

"Kushtrim brezash" ngelet gazetë e vlerave, ka luajtur një rol dhe ka treguar vlera të pamohueshme për veteranët, duke u bërë zëri dhe organi i propagandës së veteranit. Gazeta "Kushtrim brezash" është një gazetë

që shkon dhe lexohet në çdo fshat të Shqipërisë. Punë e madhe është bërë nga veteranët për botime të ndryshme historike dhe kjo gazetë i ka publikuar gjithmonë për të mbajtur gjallë dhe të pushuar zjarrin luftarak të brezave. Nëpërmjet kësaj gazete, me shkrimet dhe kujtimet e veteranëve të LANÇ-it është hedhur dritë mbi të vërtetën dhe mbi rëndësinë e ngjarjeve të mëdha të kësaj lufte.

Nëpërmjet gazetës veteranët e LANÇ-it, kanë dhënë shembullin e një bashkëpunimi në të gjitha momentet historike, kanë përkrahur pa rezerva Organizata Kombëtare për Dëshmorët e LANÇ-it dhe Dëshmorët e tjerë të Atdheut, si dhe të gjitha shoqatat atdhetare e kulturore për përkujtimin e ngjarjeve dhe të datave historike, mbrojtjen e simboleve të Kombit. Vëmendja gjithmonë e gazetës ka qenë mbrojtja e LANÇ-it, pasi aty të gjitha forcat reaksionare dhe përkrahësit e tyre ishin dhe janë që të përbaltnin këtë luftë, të mohojnë komandantët dhe komisarët që e drejtuan, udhëhoqën dhe e shpunë në fitore. Organizata e Veteranëve të LANÇ-it në këto vite të jetës së saj ka rritur dhe zgjeruar bashkëpunimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me Kosovën dhe me vende të tjera të Ballkanit. Rëndësi iu ka kushtuar veçanërisht organizatave dhe shoqatave me vendeve që u përfshinë në Koalicionin e madh Antifashist Botëror. Organizata ka forcuar lidhjet me organizatat ndërkombëtare, anëtare e të cilave është në Federatën Botërore të Luftëtarëve të Vjetër (FMAC), Federatën

Ndërkombëtare të Rezistentëve (FJR), si dhe me organizatat homologe të vendeve të tjera dhe veçanërisht me ato të vendeve fqinje.

## Organizata dhe misioni historik

Komiteti Kombëtar i Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ-it, është udhëhequr dhe drejtuar nga figura të spikatura të jetës politike të vendit, por dhe të kontributit të dhënë gjatë luftës. Vendin kryesor e zënë figurat ushtarake të luftës, komandantët e brigadave dhe të njësisve sulmuese si Beqir Balluku e Shefqet Peçi deri në vitin 1991. Më tej organizatën luftarake e kanë drejtuar kuadrot me përvijë si Pirro Dodbiba, Adnan Qatipi, Rustem Peçi e Odhise Porodini. Këta i kanë dhënë hov dhe jetë kësaj organizate që veteranët e LANÇ-it, si përfaqësuesit më besnikë e luftëtarë trima të pa trembur, që i kushtuan jetën e tyre çlirimit të Shqipërisë, të shkruanin kujtimet të kësaj epopeje dhe t'i ruanin ato si dokumente kryesore e të rëndësishëm për brezat e ardhshëm.

Në bashkëpunim me organet e pushtetit lokal, ngritën në kujtim të LANÇ-it, disa memoriale të dëshmorëve, vendosën në sheshe e shtëpi, rrugë e vende ku janë kryer aksione luftarake, pllaka përkujtimore dhe u ndërtuan varrezat e dëshmorëve. Gjithashtu është bërë përkujtimi i përvjetorëve të datave historike, si datën 28 e 29 Nëntor, 5 Maj, të Konferencës së Pezës, të 10 Korrikut, të Çlirimit të Tiranës dhe të çlirimit të qyteteve e krahinave të Shqipërisë, përkujtimin e ditëve të formimit të njësisve partizane, etj. Në kuadër të këtyre veprimtarive, rëndësi iu është kushtuar gjithmonë punës me nxënësit e shkollave, zhvillimit të referateve dhe zhvillimit të aksioneve luftarake në qytet e në fshatra, zhvillimi i ekskursioneve në vendet historike, vizita e biseda me familjet e dëshmorëve etj. Rëndësi iu kushtua ndërtimit të strukturës organizative, ku në të gjithë bashkitë, njësitë administrative, në fshatra dhe në lagje të qyteteve janë ngritur organizata të veteranëve, të cilat po punojnë për realizimin e detyrave të shtruar nga Konferenca e 12-të Kombëtare dhe Kryesia e Përgjithshme e Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ-it. Organizata e Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ-it për ruajtjen, mbrojtjen dhe propagandimin e vlerave atdhetare të luftës më heroike të bërë nga populli shqiptar, siç ishte Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, është vlerësuar dhe nderuar nga presidenti i Republikës me dekoratën "Nderi i Kombit", më 24 dhjetor 2019.

# Luiza Gega bën histori, e pesta në botë

Luiza Gega nuk njeh më limite me rezultatet e saj. 34-vjeçarja përfaqësuese e Forcave të Armatosura siguroi rezultatin më të mirë në historinë e atletikës shqiptare.

Ajo u rendit e pesta në botë në garën e 3 mijë metrave me pengesa në Botërorin e Atletikës që po zhvillohet në Oregon të SHBA-së.

Gega përmirësoi edhe rekordin kombëtar në këtë garë, duke kapur kohën 9.10.04.

Deri më tani Gega rezultatin më të mirë e kishte po në botëror, në vendin e 8.

Gara e radhës ku ajo bashkë me trajnerin Taulant Stërmasi do të kërkojnë mrekullinë e radhës është europiani i Mynihut në Gjermani.



## Njoftim!

Mbi datat, procedurat dhe dokumentacionin e aplikimit, konkurrimit dhe regjistrimit për praninë në ciklin e parë të studimeve, programi Bachelor, në tre degët: 1. Shkenca Ushtarake; 2. Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes; 3. Navigim dhe Komandim Detar në Fushën e Mbrojtjes, për vitin akademik 2022-2023.

Njoftojmë të gjithë të interesuarit se Akademia e Forcave të Armatosura (Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë) hap regjistrimet për praninë në ciklin e parë të studimeve, programi Bachelor, për vitin akademik 2022-2023.

Datat e aplikimit, konkurrimit të aplikantëve/kandidatëve dhe regjistrimit të fituesve (Raundi i Parë) do të jenë si më poshtë vijon:

- Regjistrimi i aplikantëve për konkurrim: 08 - 11 gusht 2022, (orari 09:00 - 16:00)
- Shpallja e listave të aplikantëve të regjistruar për konkurrim: 11 gusht 2022
- Zhvillimi i konkursit (testimeve): 15 - 20 Gusht 2022
- Ekzaminimi mjekësor
- Testimi fizik
- Testimi intelektual
- Testimi psikologjik

- Shpallja e kandidatëve fitues: 30 Gusht 2022.
- Ankimimi: 01 Shtator 2022.
- Regjistrimi i kandidatëve fitues të raundit të parë: 02 - 15 Shtator 2022.
- Çregjistrimi i aplikantëve fitues: 16 - 17 Shtator 2022.
- Dokumentacioni i aplikimit për konkurrim (Raundi i Parë):
- Dokument identifikimi (dokument origjinal dhe një fotokopje e kartës së identitetit/ pasaportës;
- Kërkesë me shkrim e aplikantit, për ndjekjen e studimeve;
- Certifikatë familjare, copë 1 (një);

**REKRUTIM**  
FORCAT E ARMATOSURA  
TË SHQIPËRISË

**3** ARSYE PSE DUHET TË ZGJEDHIM  
AKADEMINË E FORCAVE TË  
ARMATOSURA

PAGESË MUJORE NDIHMËSE PËR ÇDO STUDENT  
PËR TË GJITHË PERIUHËN E STUDIMIT

AKOMODIM DHE USHQIM FALAS  
PËR 3 VITET E STUDIMIT NË AKADEMI

TARIFË STUDIMI  
0 LEKË NË VIT

REGJISTROHU TANI PËRMES PORTALIT U-ALBANIA  
[www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al)

- Fotografi për dokument, në përmasat (4 x 6), copë 2 (dy);
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së maturës shtetërore ose e dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar në QSHA;
- Raport mjekësor mbi aftësinë shëndetësore për studime, lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit të aplikantit, shoqëruar edhe me një raport shpjegues në të cilin të deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, (nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në

anamnezën e tij personale, si dhe që nuk është përdorues i lëndëve narkotike);

□ Fletë analiza mjekësore, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaktit dhe/ose bankat e gjaktit apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, për agjentë infektivë (Hepatit B; Hepatit C; Hepatit D; HIV/AIDS, sifiliz); grupin e gjaktit, si dhe testet për lëndë narkotike lëshuar nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

1. Deklaratë e aplikantit, (Shtojca 1);
2. Formular i të dhënave personale të aplikantit (Aneksi A), mbi të dhënat personale të aplikantit;
3. Formular vetëdeklarimi (Aneksi B), mbi të dhënat personale të aplikantit në lidhje me statusin juridik;
4. Formular vetëdeklarimi për gjendjen shëndetësore të kandidatit për oficer aktiv (Aneksi C);
5. Mandat pagesë e tarifës së konkurimit në vlerën 2 000 lekë për studentët që regjistrohen për diplomë të parë Bachelor dhe në vlerën 4 000 lekë për studentët që regjistrohen për diplomë të dytë Bachelor.

□ Për sa më sipër sqarojmë se, formularët “Shtojca 1”; “Aneksi A”, “Aneksi B”, “Aneksi C”, si “Fatura për pagesë të tarifës së aplikimit”, do të ofrohen nga personeli i sekretarisë mësimore për plotësim/nënshkrim nga aplikanti, ditën e aplikimit.

□ Dokumentacioni shtesë për regjistrimin e kandidatëve të shpallur fitues të konkursit:

1. Dëshmi penaliteti;
  2. Vërtetim nga gjykata;
  3. Vërtetim nga prokuroria;
  4. Vërtetim nga përbarimi.
- Të dhënat për rregulloren e konkursit, testeve, gjenden në faqen zyrtare të AFA-së dhe të Ministrisë së Mbrojtjes. Publikimi i listës së renditjes së aplikantëve fitues do të bëhet brenda datës 30 gusht 2022, duke përdorur si element identifikues vetëm ID e aplikantëve.